



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
Drejtoria e Financës

Nr. Prot.

Tiranë, _____ 2015

**RAPORT MONITORIMI
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**

(Janar – Dhjetor 2014)

Detajimi i buxhetit për vitin 2014 është mbështetur në Programin Buxhetor Afatmesëm 2014-2016 si dhe në prioritetet e përcaktuara në Programin e Qeverisë. Detajim është realizuar sipas shtatë programeve buxhetore ose niveleve arsimore ku janë mbajtur parasysh objektivat, qëllimi i synuar, përfituesit, si dhe lidhjet midis politikave sektoriale dhe aktiviteteve nga ku janë përcaktuar dhe buxhetet për çdo program, të parashikuara në PBA për periudhën 2014-2016.

Ministria e Arsimit dhe Sporti për vitin 2014, administron dhe menaxhon fondet buxhetore, sipas shtatë programeve të miratuara, të listuar me poshtë:

1. Programi “Planifikim, menaxhim dhe administrim”
2. Programi “Arsimi Bazë”
3. Programi “Arsimi i Mesëm i Pergjithshëm”
4. Programi “Arsimi i Mesëm Profesional dhe Social-kulturor”
5. Programi “Arsimi i Lartë”
6. Programi “Kërkimi shkencor”.
7. Programi “Për sportin”.

Ndër objektivat dhe reformat kryesore të realizuara nga MAS për periudhën 12-mujore Janar -Shatator 2014:

- ✚ Realizuar Kornizën e re Kurrikulare të bazuar në kompetenca, konform rekomandimeve të Bashkimit Europian për arsimin, e cila e sjell arsimin shqiptar në shekullin e 21-të. Tashmë nuk ekziston asnjë vështirësi për të ndjekur shkollat europiane, pasi korniza kurrikulare që po unifkohet, është ajo zyrtare e BE-së.
- ✚ Jetësuar unifikimin e sistemit arsimor parauniversitar të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës nëpërmjet nënshkrimit të Marrëveshjes për Unifikimin e Kurrikulës së Sistemit Arsimor Parauniversitar “Një shkollë shqiptare për të gjitha hapësirat shqipfolëse”,. Tashmë, një nxënës/e i Shqipërisë nuk do të ketë më asnjë pengesë për të vijuar shkollimin e tij/të saj në Kosovë dhe anasjelltas.
- ✚ Në Maturën Shtetërore 2014-të, realizuar kthesën e duhur në drejtim të meritokracisë, duke unifikuuar standardin e cilësisë në gjithë vendin. Ndershmëri, meritokraci dhe standard në MSh 2014, duke administruar në mënyrë rigorozë dhe të unifikuuar të gjithë procesin. E deklaruar dhe rritëm paraprakisht në 20% pragun e kalueshmërisë, rritëm në 26% peshën e mesatares, nisur nga parimi që shkolla duhet të ofrojë dije të vlefshme dhe jo thjesht diploma.
- ✚ Kemi filluar sipërmarrjen madhore të digjitalizimit të sistemit arsimor shqiptar, duke rinegociuar dhe ratifikuar marrëveshjen për Projektin “Modernizimi i sistemit arsimor në Shqipëri nëpërmjet

e-Edukimit”, me Qeverinë Austriake, i cili do të pilotohet fillimisht në 30 shkolla të mesme të përgjithshme në vend.

- ✚ Realizuar projektin “Shkolla si qendra komunitare” t’ia kthejmë ato komunitetit. “Shkolla si qendra komunitare” vazhdon të mbetet për ne projekti ynë i madh. Në 66 shkolla 9-vjeçare dhe të mesme ka nisur zbatimin e projektit “Shkolla, Qendër Komunitare”, falë mbështetjes edhe të donatorëve europianë dhe ShBA-ve. Programi zhvillohet nga vetë shkollat në bazë të specifikës së tyre, duke promovuar bashkëpunimin mësues-prindër-nxënës. Për herë të parë, prindërit, mësuesit dhe nxënësit do të kenë në dorë një instrument të rëndësishëm për verifikimin e cilësisë në gjithë sistemin parauniversitar, sepse për herë të parë ne realizuam Kartën e Performancës së Shkollës.
- ✚ Është rishikuar katalogun e teksteve shkollore 2014, që këtë vit shkollor, për cilësinë e teksteve. 120 tituj librash mësimorë problematikë u hoqën nga katalogu i vitit 2014, pas konsultimit me mësuesit, prindërit dhe shtëpitë botuese. Falë një komunikimi të ri, siguroam që çdo vërejtje e dhënë nga mësuesit, për tekste të veçanta, sado e vogël qoftë, të përmirësohet nga botuesit që këtë shtator.
- ✚ Reforma e Arsimit të Lartë është kryefjala e reformave në gjithë sistemin tonë arsimor. Treguam një risi në politikëbërje përmes një procesi të veçantë që u ndoq për Reformën e Arsimit të Lartë. Kemi tashmë gati një reformë tërësore të sistemit të arsimit të lartë, e cila synon rritjen e cilësisë në të gjithë sistemin, pa cenuar aspak mundësitë e të rinjve për t’u arsimuar, nëpërmjet ngritjes së një Komisioni të pavarur, i cili mundësoi një proces të zhvilluar në transparencë të plotë, duke garantuar gjithëpërfshirjen e grupeve të interesit, e aktorëve të AL-së pa asnjë përjashtim. Raporti përfundimtar i komisionit përfshiu të gjitha vërejtjet konstruktive, ndaj u mirëprit edhe nga ata që reformën e panë në fillim me dyshim.
- ✚ Tashmë kemi ndërmarrë hapat e duhur në rrugën e kthimit të autoritetit të ligjit në institucionet e arsimit të lartë dhe në drejtim të frenimit të rrënimit të arsimit të lartë, si çelës i kthimit të besimit të publikut në IAL-të shqiptare, duke iniciuar procesin e Verifikimit të Kushteve të Ligjshmërisë në të gjitha IAL-të shqiptare, publike dhe private. Kemi përmbyllur vlerësimin paraprak dhe fillojmë punën për akreditimin e të gjitha IAL-ve me një agjenci britanike anëtare e ENQAS, brenda muajit dhjetor të këtij viti.
- ✚ U dhamë mundësinë studentëve praktikantë dhe personelit akademik për të studiuar jashtë vendit, siguroam mbështetje për sportin dhe aktivitetet rinore, duke e bërë Shqipërinë tashmë pjesëmarrëse me titull të plotë në programin Erasmus+, programi i BE-së për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin, propozuar nga Komisioni Europian, që synon të nxisë modernizimin e sistemeve arsimore.
- ✚ Nënshkruam marrëveshjen “**Horizon 2020**”, Programi i BE-së për Kërkim dhe Inovacion, i cili premtonte arritje të mëdha në kërkimin shkencor dhe synon sigurimin e konkurrueshmërisë së Europës në nivel global.
- ✚ Në sport, rritëm numrin e orëve të lëndës së edukimit fizik në shkollat e arsimit parauniversitar me nisjen e vitit shkollor 2014-2015.
- ✚ Realizuar/pagesat për shpërblimet për sportistët me rezultate kombëtare dhe ndërkombëtare të munguara ndër vite. Sot nuk ka më sportistë që të mos kenë marrë pagesat që ua jep ligji për shkak të rezultateve të tyre. Ajo ç’ka ne po ndërtojmë së bashku me komunitetin e sportistëve, është një status i ri për sportistit elitare përmes investimeve të shumta në sport. 140 milionë lekë është vlera për mbështetjen e Federatës Kombëtare pjesëmarrëse në Kampionatin Botëror të Peshëngritjes.
- ✚ Rritja me 3-5% e numrit të fëmijëve që frekuentojnë arsimin parashkollor përmes sigurimit të kushteve të infrastrukturës dhe mbështetje me personel mësimor-edukativ të kualifikuar dhe trajnuar, duke siguruar mundësi financimi për trajnimin e tyre;
- ✚ Siguroam i shërbimit të internetit në 1,350 shkolla të sistemit parauniversitar, implementimi i platformes e-learning dhe pajisja me tableta për nxënësit e klasave të 10-11-12 të arsimit të mesëm të përgjithshëm, projekt i nisur dhe financuar në vitin 2014;

- ✚ Siguruam i financimit të shërbimit të transportit për rreth 30.000 nxënës që mësojnë në një distancë prej më shumë se 2 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre si dhe rreth 11.000 mësuesve që punojnë e banojnë më shumë se rreth 5 km nga vendbanimi i tyre.
- ✚ Janë rimbursuar shpenzimeve të blerjes së teksteve shkollore për vitin akademik 2013-2014 për rreth 120 mijë nxënës të kategorive të veçanta dhe shtresa në nevojë, ose për rreth 25% të totalit të nxënësve me rreth 320 milion lekë dhe po rimbursojmë shpenzimet për tekstet e blera për vitin akademik 2014-2015 për rreth 110 mijë fëmijë.
- ✚ Siguruam kushteve për zhvillimin e maturës shtetërore për rreth 45.000 nxënës maturanët, me një standard të ri sigurie dhe cilësie.
- ✚ Siguruam financim dhe trajtimin me kuotë ushqimore (bursa) për rreth 3.500 nxënës dhe 8000 studentë, me aftësi të kufizuara dhe për nxënësit që vijnë nga familjet në nevojë si dhe me aftësi të kufizuara dhe nga familjet në nevojë.
- ✚ Realizuar procedurat për pajisjen me orëdi e pajisje për 80 institucione arsimore/ shkollat të arsimit para universitar, të cilat kanë mungesa apo pajisje të amortizuara dhe që kanë nevojë emergjente për rinovim;
- ✚ Sigurohet financimi pjesës së mbetur për 110 projekte në arsimin parauniversitar (63 objekte arsimorë dhe 46 terrene sportive të financuar nga FZHR 2014 për arsimin parauniversitar), me objektiv sigurimin dhe përmirësimin e kushteve të infrastrukturës në mjediset e sistemit para universitar, shmangien dhe reduktimin e zhvillimit të mësimin me turne, reduktimin e numrit të nxënësve për klase, me synim realizimin që të gjithë shkollat të arrihet raporti 30 nxënës/klasë;
- ✚ Sigurimin e shërbimit mësimor- edukativ dhe stafit të nevojshëm për orët e edukimit fizik dhe përmirësimin e kushteve infrastrukturore të 46 terreneve sportive në 12 qarqe të vendit, me objektiv realizimin e objektivit “shkolla qendër komunitare”;
- ✚ Vazhdimin e reformës së arsimit të lartë, duke përmirësuar kuadrin ligjor dhe rregullator, rishikimin e skemës së financimit të IAL-ve, përmirësimin e kushteve të infrastrukturës së IAL-ve publike, përmes sigurimit të mbështetjes buxhetore për projektet e nisura, monitorimin e zbatimit të ligjshmërisë së IAL publike dhe private si dhe rritjen e kontrollit për përmbushjen e standardeve të akreditimit të tyre.
- ✚ Mbështetje financiare për studentët ekselentë që studiojnë në 15 universitetet më të mira, referuar renditjes së “*Times Higher Education*”, si dhe punonjesve të administratës publike, të cilët përfitojnë trajnime/kualifikime apo studime të ciklit të dytë dhe tretë në 300 universitetet më të mira të botës;
- ✚ Sigurimi i financimit me mbështetje buxhetore për 8 shoqëri të trajtimit të studenteve ku ofrohet mbështetje financiare për rreth 12 mijë studentë që akomodohen në këto shoqëri;
- ✚ Sigurimin e mbështetjes me “grand buxhetor” të rreth 20 federatave sportive si dhe mbështetje për sportistët me rezultate të larta sportive/medalistët Sigurimi i financimit për projektin “Tirana Olimpik Park” projekt i cili do të mundësojë krijimin e infrastrukturës së nevojshme, me standard dhe cilësi të larta të ushtrimit të sporteve, veçanërisht sportit elitare, duke siguruar kushtet e përshtatshme për sportin e peshëngritjes, atletikës dhe lojërave me dorë si dhe mjediset komferte për agjencinë e shërbimit të sportit dhe personelin e federatave sportive;
- ✚ Janë likuiduar detyrime, vendime gjyqësore, si dhe boxhe të trashëguara në prej dy apo më shumë vjetësh të cilat ishin një pengesë e vërtetë për implementimin e buxhetin dhe realizimin e projekteve për vitin 2014,

Një analizë më e detajuar për fodat e miratuara për MAS së bashku me të ardhurat dytësore dhe realizuara për periudhën janar-Dhjetor 2014, sipas grup artikujve janë sa vijon;

Për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për vitin 2014, fondet e **miratuara** me ligjin nr.185/2013 datë 28.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, janë në shumën prej **40 miliard e 111.4** milion lekë. Fondet për arsimin, krahasuar me shpenzimet publike për vitin 2014 arrijnë në **8.8%** dhe ndaj produktit të brendshëm bruto për vitin 2014 janë në nivelin **2.83%**.

Buxheti i rishikuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për vitin 2014, të miratuara me ligjin nr.185/2013 datë 28.12.2013“Për buxhetin e vitit 2014”, i ndryshuar arrin në shumën prej **42 miliard e 551 milion lekë**.

Buxheti i rishikuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për vitin 2014, krahasuar me shpenzimet publike për vitin 2014 arrijnë në **9%** dhe ndaj produktit të brendshëm bruto për vitin 2014 janë në nivelin **2.9%**.

Fondet “Për Arsimit”, ku janë përfshirë si pjesë e buxheti të arsimit, **të ardhurat e universitete publike** në shumën prej **4 miliard e 81 milion lekë pa u përfshirë fondet për arsimin** nga Njësitë e Qeversjes Vendore, si dhe Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme e te tjera institucione me fonde në shërbimim të arsimit, krahasuar me shpenzimet publike për vitin 2014 , të arrijnë **46 miliard 820 milion lekë** ose në **9.9%** dhe ndaj produktit të brendshëm bruto janë në nivelin **3.2%**.

Fondet “Për Arsimit”, ku janë përfshirë si pjesë e buxheti të arsimit, të ardhurat e universitete publike **përfshirë dhe fondet parashikuara për arsimin** nga Njësitë e Qeversjes Vendore, si dhe Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme e te tjera institucione me fonde në shërbimim të arsimit, krahasuar me shpenzimet publike për vitin 2014, **parashikohet të arrijnë në 10.7% dhe ndaj produktit të brendshëm bruto janë në nivelin 3.4%.**

Buxheti i akorduar për MAS, synon të realizojë objektivat e MAS për vitin 2014, si dhe vijimin e reformave të synuara në vitin 2015.

Fondet për shpenzimet korente, ku përfshihen fonet për shpenzime personeli si dhe fondet për shpenzime për blerje materiale dhe shërbime arrijnë në kuotën 41 miliard 380 milion lekë ose 88 % të fondeve të miratuara për vitin 2014. Fonde për shpenzime kapitale janë 5 miliard e 429 milion lekë ose rreth 12 % e fondeve të planifikuara në buxhetin e vitin 2014

a) **Fondet e shpenzimeve për personelin për vitin 2014;** janë planifikuar në shumën 29 miliard e 710 milion lekë, fond i cili garanton mbulimin e pagave dhe sigurimeve shoqërore të numrin aktual të punonjësive të arsimit prej 38,953 punonjës të arsimit prauniversitar . Shpenzimet e personelit të miratuar për vitin 2014 zënë rreth **75%** e buxhetit të arsimit, ndërsa ndaj shpenzimeve korentë janë në masën 81.6%.

Fondet e shpenzimeve për personelin për vitin 2014 “të rishikuara” pas shpërndarjes së tansfertës së pakushtëzuar nga IAL publike për vitin 2014 arrijnë në masën **35 miliard e 943 milion lekë ose 78%** e fondeve të miratuara/rishikuara për vitin 2014. Realizimi për vitin 2014 është në masën 35 miliard 90 milion lekë në masën 98% e fondeve të planifikuara për vitin 2014.

b) **Fondet për shpenzime korente/operative për blerje mallra dhe shërbime;** Fondet e miratuar për mbulimin e shpenzimeve për blerjen e mallrave dhe shërbime nga të tretë për vitin 2014 janë **6 miliard 691 milion lekë** ose 17.4% e buxhetit të rishikuar. Zërat kryesorë në këtë grupartikull të shpenzimeve të tjera korrente janë, shpenzime për transportin e nxënësve që kanë vendbanimi mbi 2 km nga shkolla si dhe transportin e mësuesve që punojnë mbi 5 Km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë, shpenzime për blerje mjete didaktike, shpenzime për shërbim interneti në shkolla, shpenzime për transfertat tek individët për blerjen e tekstet shkollore, shpenzime për bursat e nxënësve dhe studentëve, shpenzime për fondin e ekselencës etj, të cilat zënë edhe pjesën më të madhe të kësaj kategorie të shpenzimeve etj.

Pas shpërndarjes së tansfertës së pakushtëzuar nga IAL publike për vitin 2014 si dhe fondeve të celura për likuidim detyrimesh “borxheve nga viti 2013” **fondet për shpenzime korente/operative për blerje mallra dhe shërbime,** arrijnë në masën **5 miliard e 436 milion lekë** ose 11.6% e fondeve të miratuara/ rishikuara për vitin 2014. **Realizimi për periudhën 12-mujore Janar –Dhjetor 2014 është në masën 5 miliard 217.3 milion lekë në masën 96%.**

Fondet për shpenzime kapitale, për vitin 2014 janë miratuar në kuotën 3 miliardë e 440 milion lekë ose rreth 8.6% e buxheti të miratuar për MAS, për vitin 2014. Pas rishikimit të buxhetit për vitin 2014, fondet për investime janë në masën **4 miliard e 631 milion lekë ose rreth 10.5%** e fondeve të miratuara për vitin 2014, së bashku me të ardhurat e IAL publike fondet për investime kapitale arrijnë në **5 miliard e 440 milion lekë** ose 12% e fondeve për vitin 2014.

Realizimi i shpenzimeve kapitale për periudhën 12-mujore së bashku me të ardhurat e siguruar nga IAL publike për vitin 2014 arrin në arrin në **4 miliard 714 milion lekë ose në masën 87 %** e planit të rishikuar për vitin 2014 duke përfshirë dhe të ardhurat nga IAL publike.

Fondet për investime kapitale të klasifikuara sipas burimit të financimi për vitin 2014 janë;

- të financuara nga buxheti i shtetit janë **4 miliard e 497 milion lekë ose 97.3 %** e fondit të investimeve , të realizuara në masën 3 miliard 989 milion lekë ose 86.2%;
- fonde me financim të huaj janë **125 milion lekë** ose 2.7% të fondit të investimeve i planifikuara për vitin 2014, të realizuara në masën 100%. Burimi i financimit të huaj janë nga Projekti IPA BE, KE Projekti CARDS, Qeveria Zvicerane, Qeveria Italiane.
- Me burim financimi nga të ardhurat e IAL publike janë 808.9 milion lekë dhe të realizuara në masën 725.2 milion lekë **ose 90 %**.

Realizimi i investimeve për vitin 2014 ndaj planit të realizuar në vitin 2013 është 1.2 miliard lekë më shumë ose 44% më shumë.

Në total për periudhën 12-mujore Janar –Dhjetor 2014, realizimi i fondeve është në masën **40 miliard e 850 milion lekë ose 96%** ndaj planit vjetor të rishikuar për vitin 2014, në analizë së bashku me të ardhurat dytësore të realizuara për periudhën 12-mujore 2014, fondet e realizuara për këtë periudhë arrijnë në **45 miliard e 18 milion lekë ose në masën 96%**, e buxhetit të rishikuar për vitin 2014, shpenzimet e realizuara në vitin 2014 në arsim **pa u përfshirë fondet për arsimin** nga Njësitë e Qeversjes Vendore, si dhe Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme krahasuar me shpenzimet publike për vitin 2014 ,arrijnë në **9.9%** dhe ndaj produktit të brendshëm bruto janë në nivelin **3.2%**.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grupartikujve për 12- mujorin 2014 rezulton si më poshtë:

Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzime korente **98 %**
 Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet kapitale **87 %**

Gjithsej 96 %

Tab_1 Fondet buxhetore sipas grup artikujve të planifikuara për vitin 2014, **plani i rishikuar + te ardhurat dytësore** si dhe realizimi faktik për 12-mujorin në mijë lekë dhe në %.

Artikulli Kodi	Emri	PBA Plan 2014	Buxheti Fillestar 2014	*Buxheti i Rishikuar+ te ardhurat 2014	Realizimi 12- mujor 2014	Diferenca Realiz-Buxh rish 2014	Realizimi 12-mujor 2014 ne %
600-601	Paga+Sigurime Shoqërore	29,500,998	29,710,500	35,943,950	35,090,093	-853,856	98%
602-606	Mallra dhe Shërbime të Tjera	7,240,000	6,691,228	5,436,227	5,217,289	-218,938	96%
230-231	Kapitale të Trupezuara Patrupëzuara	2,920,000	3,440,000	5,440,550	4,711,080	-729,470	87%
Totali	Korrente dhe Kapitale	39,660,998	39,841,728	46,820,727	45,018,462	-1,802,264	96%

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit konfirmuar nga Ministria e Financës.



Tab_1.1, Fondet buxhetore sipas programeve buxhetore për vitin 2014, si dhe realizimi per periudhën Janar – Dhjetor 2014,

Nr	Emri i programit	Buxheti I miratuar per 2014	Buxheti Rishikuar 2014	Struktura	Realizimi 12- mujor 2014		
		(milion lekë)	(milion lekë)	Ne %	Ne milion /lekë	Struktura ne % ndaj buxh total	Struktura ne % ndaj realizim
1	Planif. menaxhim administrim	787.5	812.4	1.9%	696.6	86%	1.7%
2	Arsimi baze	24,950.0	26,136.7	61.4%	25,135.8	96%	61.5%
3	Arsimi i mesem pergjith	5,998.2	6,559.8	15.4%	6,148.5	94%	15.1%
4	Arsimi profesional	2,214.5	2,395.2	5.6%	2,259.0	94%	5.5%
5	Arsimi i larte	5,546.5	5,647.1	13.3%	5,629.3	100%	13.8%
6	Kerkimi shkencor	177.0	181.5	0.4%	172.8	95%	0.4%
7	Programi per Sportin	818.8	818.8	1.9%	808.2	99%	2.0%
	Totali	40,492.6	42,551.6	100.0%	40,850.3	96%	100.0%



Tab_1.2, Fondet buxhetore sipas programeve buxhetore se bashku me te ardhurat për vitin 2014 si dhe realizimi per periudhën Janar- Dhjetor 2014,

Nr	Emri i programit	Buxheti I miratuar per 2014	Buxheti Rishikuar 2014	Struktura	Realizimi 12- mujor 2014		
		(milion lekë)	(milion lekë)	Ne %	Ne milion /lekë	realizim ne % ndaj buxhetit te rishikuar	Struktura ne % ndaj realizim
1	Planif. Menaxhim	787.5	815.4	1.7%	699.6	86%	1.6%
2	Arsimi baze	24,950.0	26,150.9	55.9%	25,150.0	96%	55.9%
3	Arsimi i mes pergjithshem	5,998.2	6,559.9	14.0%	6,148.5	94%	13.7%
4	Arsimi i profesional	2,214.5	2,395.3	5.1%	2,259.1	94%	5.0%
5	Arsimi i larte	5,546.5	9,808.6	20.9%	9,689.8	99%	21.5%
6	Kerkimi shkencor	177.0	271.4	0.6%	262.7	97%	0.6%
7	Programi per Sportin	819.3	819.3	1.9%	808.7	99%	2.0%
	Totali	40,493.1	46,820.7	100.0%	45,018.5	96%	100.0%

Tab_2, Struktura e fondeve për arsimin për vitin 2014 sipas grup artikujve buxhetore në %;



Tab_3 Struktura e buxhetit të planifikuar dhe realizuar për vitin 2014, sipas programeve buxhetore në %



Tab 5. **Plani I Shpenzimeve Kapitale per vitin 2014 si dhe realizimi i per 12- mujorin 2014, sipas burimit të financimit ne lekë**

b	Plani Investimeve kapitale per vitin 2014					Realizimi i Shpenzimeve Kapitale 12 Mper vitin 2014				
	Buxheti+ aktet normative	shtesa te tjera nga Buxheti "Borxhi"+ te ardhurat	Buxheti I rishikuar 2014	Huaj I rishikuar	Totali i Shp. Kapitale	Financim I Brendshem 2014 + te ardhurat	Realizimi ne % ndaj planit 2014	Realizimi Financim Huaj	Financim I huaj Realizimi ne %	Totali i Shp. Kapitale
Totali	3,385,351	1,930,199	5,315,550	125,000	5,440,550	4,585,034	86%	129,046	100%	4,714,079.95
			98%	2%	100%	97%		3%		87%
01110	47,500	-4,036	43,464	0	43,464	481	1%	0	0%	481
09120	1,908,378	532,134	2,440,512	0	2,440,512	2,102,257	86%	0	0%	2,102,257
09230	1,123,869	147,260	1,271,129	0	1,271,129	1,030,245	81%	0	0%	1,030,245
09240	166,613	38,375	204,988	100,000	304,988	185,289	61%	91,062	91%	276,351
09450	138,991	990,301	1,129,292	25,000	1,154,292	1,040,873	90%	37,985	0%	1,078,857
08140	0	205,141	205,141	0	205,141	204,965	100%	0	0%	204,965
09770	0	21,025	21,025	0	21,025	20,925	0%	0	0%	20,925

Shënim; akti normativ nr. 2, datë 29.12.2014, nuk është zbatuar plotësisht në programin e arsimit të lartë pasi nuk kishte mundësi pakësimi për shumën prej 17.1 milion lekë, si dhe në programin për Zhvillimine sportit në shumën prej 2 milion lekë pasi dhe në këtë program nk kishte mundësi pakësimi.

Në mënyrë më analitike sipas gjashtë programeve buxhetore, realizmi i fondeve të buxhetit dhe produkteve të parashikuara për periudhen 12- mujore 2014, paraqitet sa vijon;

I – Programi buxhetor PLANIFIKIM-MENAXHIM. (Titulli i programit 01110);

Objektivat kryesore:

Objektiv 1). Forcimi i kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese, nëpërmjet programeve trajnuese dhe zhvilluese me 15% të punonjësve në MASH, DAR dhe ZA. (për 100 punonjës). Përgatitja e akteve ligjore dhe nënligjore të sistemit arsimor

Objektiv 2). Përmirësimi i kushteve të punës, për rritjen e eficensës dhe efektivitetit në punë, nëpërmjet sigurimit të shërbimeve bazë (materiale, energji, internet, telefon ngrohje etj), si dhe rinovimit të paisjeve e aseteve të qëndrueshme me 10% në vit, pajisjeve të zyrave, pajisje teknologjike, rikonstruksionin/zgjerimit e objekteve ekzistuese, si dhe ndërtimeve të reja.

Objektiv 3). Zhvillimi i sistemit të informacionit EMIS në përputhje me standardet operationale në arsim, nëpërmjet shtrirjes dhe funksionimit të sistemit EMIS në të gjithë DAR/ZA. Publikimi për çdo vit shkollor i raportit të arritjeve të sistemit arsimor parauniversitar

Objektiv 4). Vlerësimi i cilësisë së shërbimit arsimor mbi bazën e treguesve, duke ndërtuar një sistem të qëndrueshëm e transparent monitorimi, në planifikimin dhe përdorim e burimeve njerëzore, financiare dhe materiale në arsim.

Objektiv 5). Auditimi dhe inspektimi i 30% të institucioneve arsimore, mbështetur në praktikat më të mira ndërkombëtare.

Objektiv 6). Trajnimi i 80-100 drejtuesve të shkollave për realizimin e autonomisë së institucioneve arsimore/shkollës në funksion të decentralizimi i shërbimit arsimor, si dhe rritjes të autonomisë së shkollave duke fuqizuar kapacitetet planifikuese dhe menaxhuese në shkollë.

Gjatë kësaj periudhe në MAS është punuar me përkushtim për zhvillimin dhe imlementimin e reformës në arsim dhe për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore të propozuara në planin e punës për “Marticën e akteve ligjore dhe nënligjore për vitin 2014”;

- 1. Janë propozuar për miratim në KM, për ndryshime në tre akte ligjore dhe janë miratuar në KM dhe në Kuvendin e Shqipërisë;**

2. **Janë hartuar dhe propozuar për miratim në KM, 37 (tridhjetë e shtatë) projektvendime**, për ndryshime në akte nënligjore dhe janë miratuar në KM tridhjetë e një Vendime, pjesa tjetër vijon konform grafikut të parashikuar.
3. **Janë hartuar dhe propozuar për miratim në titullarët e MAS, 36(tridhjetë e gjashtë) udhëzime të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit si dhe dy Udhëzime të përbashkëta me Ministrinë e Financave.**
4. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar **59** raporte monitorimi për institucionet publike dhe private të arsimit të lartë “Zbatimi i ligjshmërisë në institucionet e arsimit të lartë në shërbim të sigurimit të cilësisë dhe sigurimit të standardeve përmes shqyrtimit të dokumentacionit dhe verifikimit të tij në institucion”.
5. **Përzgjedhja e drejtuesve të DAR/ZA,** dhe vlerësimi i performancës së tyre. Për herë të parë sivjet u aplikua zgjedhja e drejtorëve të 13 DAR-ve me konkurs të hapur, të drejtpërdrejtë dhe transparent për mësuesët, prindërit dhe komunitetin. Pas një pune 6 mujore u zhvillua anketimi për vlerësimin e performancës së drejtuesëve të 38 DAR/ZA-ve. Në këtë anketim morën pjesë 26 867 mësues, ose 88% e numrit total të mësuesve, të cilët për herë të parë shprehën vlerësimin e tyre të lirë nga presioni i vendit të punës, në mënyrë të fshehtë dhe demokratike për punën e drejtuesve të tyre. Mbi 70% e mësuesve e vlerësuan pozitivisht punën e drejtuesve të DAR/ZA.
6. U inspektuan gjimnaze në DAR-in Tiranë, Durrës, Vlorë, Fier, Shkodër, Lezhë Kukës,

Rezultatet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, për vitin 2014

- DAB ka realizuar **13 auditime të plota nga 17 të planifikuara**, nuk është realizuar auditimi në Agjencinë Kombëtare të Provimeve, pasi ky institucion ka qenë për një periudhë të gjatë kohe me të gjithë stafin e tij në procesin e Maturës Shtetërore, si dhe nuk janë realizuar auditimet e planifikuara për vitin 2014 në pesë SHA “Trajtimi i Studentit”, pasi në këto Shoqëri janë audituar nga NjAB e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes.
- Janë realizuar **12 auditime të përputhshmërisë** nga 15 të planifikuara dhe 11 auditime financiare nga 15 të planifikuara.
- NjAB, ka kryer **7 auditime të pa planifikuara** në 7 institucione, kjo me kërkesë të Menaxhimit. i është dhënë prioritet, auditimeve në subjektet që kanë patur një kohë të gjatë pa u audituar dhe me fonde të mëdha, procedurave të prokurimit auditimeve në fushën e pagave dhe të shpërblimeve sistemit të burimeve njerëzore në DAR/ZA.
- 7. **ISHA ka zhvilluar veprimtarinë duke u mbështetur në planin vjetor 2014 dhe në prioritetet e MAS-it.** Kjo veprimtari ka qenë në funksion të misionit për rritjen e cilësisë së shërbimit në arsimin parauniversitar, si dhe inspektimit të zbatimit të kërkesave ligjore në arsimin parauniversitar dhe të lartë. Për këtë ISHA ka kryer monitorimin, vlerësimin, këshillimin dhe nxjerrjen e përfundimeve për zhvillimin e arsimit parauniversitar dhe ka inspektuar nivelin e zbatimit të kërkesave ligjore në arsimin e lartë.
- 8. **Gjatë vitit 2014, janë realizuar 14 inspektime të plota** (1 kopsht, 7 shkolla të arsimit bazë, 5 të mesëm dhe 1 profesional) nga 20 të planifikuara në planin vjetor të ISHA-s 2014. Nuk janë zhvilluar 4 inspektime të plota në DAR/ZA si rezultat i numrit të madh të Inspektimeve të orientuara të zhvilluara në të gjitha DAR/ZA-të;
 - 28 inspektime tematike në 12 kopshte dhe 16 shkolla me fokus zbatimin e Dispozitave Normative 2013 nga 25 të planifikuara në planin vjetor të ISHA-s 2014, për çështje, si:
 - ✓ drejtimin, administrimin dhe menaxhimin e IAP-ve,
 - ✓ cilësinë e kurrikulës së zbatuar me elementët përbërës të saj,
 - ✓ etikën profesionale,
 - ✓ mjedisin psiko-social i të nxënësve
 - **328 inspektime të orientuara nga 20 të planifikuara** në planin vjetor të ISHA-s 2014, për çështje, si:
 - ✓ planifikimi i punës në shkollat e mesme për përgatitjen e nxënësve maturanët për provimet e detyruara dhe me zgjedhje të MSH,
 - ✓ zbatimi i ligjshmërisë në shkollat jopublike.

- ✓ Burimet njerëzore DAR/ZA-të
- 350 monitoruar lidhur me procesin e:
 - ✓ përzgjedhjes dhe të shpërndarjes së teksteve shkollore në 15 shkolla në DAR Tiranë,
 - ✓ votimit të mësuesve për vlerësimin e drejtorëve të DAR-eve dhe përgjegjësve të ZA-ve,
 - ✓ teste kombëtare të klasave III dhe V në 22 DAR/ZA.
 - ✓ provimit të kualifikimit të mësuesve në të gjitha qendrat e provimit në Tiranë,
 - ✓ përgatitjes së mjediseve dhe kapaciteteve njerëzore të nevojshme për zhvillimin e MSH në bashkëpunim me MAS,
 - ✓ zhvillimit të Provimeve të Maturës Shtetërore në 7 DAR-e dhe 9 ZA,
 - ✓ zhvillimit të Provimeve të Lirimit në 13 DAR-e,
 - ✓ zhvillimit të provimeve të shkollave me kohë të pjesshme në 2 DAR-e,
 - ✓ sesionit të dytë të MSH dhe PL në 13 DAR-e,
 - ✓ zhvillimit të olimpiadave kombëtare të lëndëve matematikë, fizikë, kimi, biologji dhe informatikë në Tiranë,
 - ✓ zbatimit të Kurrikulës së re në shkollën pilot “Edith Durham”,
 - ✓ zhvillimit të konkursit të drejtorëve të gjimnazeve të DAR-it Tiranë.
- ISHA ka zgjidhur 60 ankimime që kanë ardhur në rrugë zyrtare.
- Ka realizuar 8 seminare nga plani i zhvillimit profesional të stafit nga 12 të planifikuara në planin vjetor të ISHA-s 2014, sipas nevojave të identifikuara.
- Ka trajnuar 38 DAR/ZA për Kartën e Performancës.

Tabela e aktiviteteve ISHA 2014

Lloji i aktivitetit	Arsimi parauniversitar	Arsimi i lartë	Totali
Inspektime të plota	14	-	14
Inspektime të orientuara	274	59	333
Ankimime	60	6	66
Inspektime tematike	21	-	21
Monitorime	350		350
Totali			784

ARRITJET KRYESORE 2014:

- 1- Realizuar kthesën që garanton cilësinë në shërbimin arsimor dhe zbatimin e ligjit në institucionet arsimore.
- 2- Rritëm e numrin e inspektimeve duke ndikuar në arritjen në përfundime më të sakta në sistem. Gjithsej 784 inspektime, monitorime shqyrtim e animimi.
- 3- E kthyem inspektimin në një realitet që vlerëson situatën dhe propozon masa përmirësimi - për institucionet dhe punonjësit arsimore.
- 4- Reformuam Procedurën e Inspektimit duke ndryshuar mënyrën e mbledhjes së të dhënave në proces.
- 5- Rritëm cilësinë e raportimit bazuar në prova të gjetura, shoqëruar me procesvebal inspektimi
- 6- Monitoruam me korrektësi Maturën Shtetërore në kuadër të ekipit të ngritur nga MAS.
- 7- Krijua Sektorin e Inspektimit të Ligjshmërisë në Arsimin e Lartë dhe filluam inspektimin në të gjitha IAL-et.
- 8- ISHA është pjesë integrale e reformave që ka ndërmarrë MAS (si Reforma Kurrikulare në Arsimin Parauniversitar; Reforma në Arsimin e Lartë; Hartimi i Strategjisë 2014-2020, Hartimi dhe botimi i Kartës së Performancës së Shkollës në AP).

Fondet e rishikuara për këtë program janë 818.8 milion dhe zë rreth 1.9% të buxhetit të MAS, realizimi për periudhën - mujore është 518.1 milion lekë në këtë program në masëm 63% ndaj planit vjetor ose 1.7% e totalin e fondeve të realizuara për periudhën 9-mujore të vitit 2014

Fondet për shpenzime korrente sipas planit 2014 janë 766 milion lekë

- a) Fondet për shpenzime personeli në zërin “Pagat dhe sigurimet shoqërore, artikulli 600-601”, arrijnë nga 570.9 milion lekë në vitin 2014 për periudhën 9-mujore realizimi është në masën **385.6 milion lekë ose 46%**, me një rritje mesatare vjetore prej 1-3% në vit.
- b) **Fondet për shpenzime personeli për vitin 2014 kanë mbuluar pagat si dhe sigurimet shoqërore** për 656 punonjës nga të cilët:
 - ✚ Aparati i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nga 92 në 111 punonjës (pas ndryshimeve të strukturën e miratuar/ ndryshuar për vitin 2014)
 - ✚ Drejtoritë Arsimore Rajonale, 13 drejtori me 270 punonjës e specialistë
 - ✚ Zyrat Arsimore në Rrethe, 25 zyra me 240 punonjës e specialistë;
 - ✚ Inspektoriati Kombëtar i Arsimit, nga 30 në 35 punonjës (pas ndryshimeve të strukturës e miratuar për 2014)
- c) **Fonde për krijimin e kushteve të punës** për rreth 656 punonjës në Aparatin e MAS si dhe DAR/ZA për vitin 2014 janë planifikuar **168.3 milion lekë** në vit ku sipas përparësive janë parashikuar; Fonde për të mbuluar shpenzimet për energji elektrike, telefon, internet, ujë, karburant, udhëtime e dieta, kancelari, materiale të tjera zyre, si dhe likuidimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Shpenzime për trajnimin e punonjësve të MAS, DAR, ZA në kuadër të sistemit EMIS, trajnimi i drejtorëve të shkollave, trajnimi i specialistëve të sektorit të prokurimeve, sektorit të buxhetit/investimeve etj. Në këtë program është mbajtur paraysh në detajimin e buxheti për vitin 2014 dhe fondet për internet për 38 institucione DAR/ZA dhe Aparati i MAS, realizimi për periudhën 9-mujore në masën 114.5 milion lek ose 68%.
- d) **Punonjësit në listën e pritjes në këtë program për vitin 2014** është mbajtur paraysh detajimi i fondeve për punonjësit në listën e pritjes për Aparati i MAS në shumën 26.8 milion lekë, realizimi për periudhën 9-mujore në masën 15.9 milion lek ose 59%.
- e) **Fondet për shpenzime kapitale** për vitin 2014 sipas planit të rishikuar arritën në masën **50.4 milion lekë**, me synim kryesor rritjen e infrastrukturës dhe kapaciteteve menaxhuese. Burimi tyre është financim nga buxheti i shtetit 50.4 milion lekë, realizimi i shpenzimeve kapitale për periudhën 9-mujore në masën 0% janë në proces prokurimi.

Sipas projekteve kryesore paraqiten:

- a) Hartimi dhe Dizenjimi i projekteve te reja ndertimore dhe te projekte per rikonstruksionine objekteve ne ne DAR/ZA në shumën 1 milion lekë, ky projekt nuk është realizuar
- b) Rikonstruksioni dhe zgjerimi i mjediseve ekzistuese ne MAS, DAR/ZA në shumën 32.3 milion lekë,, ky projekt nuk është realizuar, vijon procedura e prokurimit.
- c) Blerja e pajisjeve elektronike/ informatike për shërbimet në MAS, DAR/ZA, në shumën 4 milion lekë, është realizuar kontrata por nuk është realizuar pagesa brenda vitit 2014;
- d) Blerja e pajisjeve e mobileri zyre per krijimin e kushteve te punes ne MAS, DAR/ZA në shumën 5 milion lekë, ky projekt nuk është realizuar.

Realizimi i fondeve për periudhën 12- mujore Janar –Dhjetor 2014, në këtë program është në masën **86%** dhe përfaqëson rreth 1.6% të totalit të shpenzimeve të realizuara nga Ministria e arsimit dhe Sportit sipas zërave kryesore.

Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzime korente	91 %
<u>Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet kapitale</u>	<u>1%</u>
Gjithsej	86 %

Në këtë program janë parashikuar për t'u realizuar produktet e mëposhtem, ecuria e të cileve krahasuar me planin vjetor 2014 jepet në tabelën:

Kodi i Prod	Emri i Produktit	Buxhet Plan 2014	Buxheti Rishikuar 2014	Fakti 9-mujor 2014	Realiz ne % ndaj planit vjetor 2014
A	Vleresimi i punes se punonjesve ne MAS ,DAR/ZA.	603,500.0	535,393.6	509,035.0	95%
D	Krijimi i kushteve te punes per punonjesit ne MAS,DAR/ZA dhe ISHA, per rishikimin e akteve ligjore dhe nenligjore te sistemit arsimor	60,000.0	159,091.6	120,556	76%
I	Rritja dhe zhvillimi i kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese, nËpËrmjet programeve trajnuese dhe zhvilluese.(Brenda dhe Jashte vendit)	15,000.0	15,000.0	14,999	100%
E	Zhvillimi i sistemit të informacionit EMIS në përputhje me standardet operacionale në arsim, nËpËrmjet shtrirjes dhe funksionimit të sistemit EMIS në të gjithë DAR/ZA. .	1,500.0	1,500.0	1,500	100%
K	Auditimi dhe inspektimi institucioneve te Sistemit te Arsimit	52,000.0	52,000.0	50,049	96%
L	Trajnimi i drejtuesve të shkollave për realizimin e autonomisë së institucioneve arsimore/shkollës në funksion të decentralizimi i shërbimit arsimor	6,000.0	6,000.0	0	0%
J	Blerja e pajisjeve e mobileri zyre per krijimin e kushteve te punes ne MAS,DAR/ZA	5,000.0	5,000.0	49	0%
C	Hartimi dhe Dizenjimi i projekteve te reja ndertimore dhe te projekte per rikonstruksionine objekteve ne ne DAR/ZA.	1,000.0	1,000.0	432	0%
F	Rikonstruksioni dhe zgjerimi i mjediseve ekzistuese ne MAS, DAR/ZA	39,500.0	40,364.3	0	0%
H	Blerja e pajisjeve elektronike/ informatike per sherbimet ne MAS,DAR/ZA	4,000.0	4,000.0	49	0%
		787,500.0	819,349.5	696,668.6	85%
	Shpenzime jashte buxhetore		2,985.3	2,985.3	
	Totali	787,500.0	815,434.7	699,604.9	86%

Disa nga aktivitetet që nuk janë realizuar ;

- ✚ Rikonstruksioni dhe zgjerimi i mjediseve ekzistuese ne MAS, DAR/ZA, nuk janë realizuar me sukses procedura e prokurimit;
- ✚ Blerja e pajisjeve elektronike/ informatike për shërbimet në MAS,DAR/ZA, nuk janë realizuar me sukses procedura e prokurimit;
- ✚ Blerja e pajisjeve e mobileri zyre per krijimin e kushteve te punes ne MAS,DAR/ZA, nuk janë realizuar me sukses procedura e prokurimit;
- ✚ Trajnimi i drejtuesve të shkollave për realizimin e autonomisë së institucioneve arsimore/shkollës në funksion të decentralizimi i shërbimit arsimore, ky projekt nuk është realizuar

Faktorë që kanë ndikuar në realizimin e buxhetit për vitin 2014;

- ✚ Celja me vonesë e fondeve për Investime kapitale në vitin 2014, endimarrja me vonesë nga Komiteti i Zhvillimit të rajoneve për vitin 2014 (Korrik 2014 thirja I-rë , Gusht 2014 thirja e II-të).
- ✚ Nuk janë realizuar me sukses procedurat e prokurimit konform ligjit të prokurimit.

II - ARSIMI BAZË. (Titulli buxhetor i programit 09120)

Objektivat kryesore :

Sigurimi i një arsimit cilësor dhe për të gjithë nxënësit duke përmirësuar kushtet e mësimdhënies e mësimnxënies duke siguruar kushte të barabarta për pjesëmarrje në arsimin bazë, për të gjithë fëmijët e grup moshës në arsimin parashkollor dhe atë të detyruar.

- ✚ **Objektiv 1)** Rritja e aksesit ne arsimin parashkollor nga 76% ne 80% ne vitin 2017 .Rritje e aksesit të fëmijëve 5 vjeçare me 15% te numrit aktual te regjistruar ne klasat përgatitore, (me 1300 fëmijë më shume). Modernizimi i arsimit parashkollor, përmes trajnimit të mësuesve (15-20% në vit), rikonstruksionit dhe ndërtimit (150 -200 klasa në vit) të kopshteve dhe pajisjes me bazë materiale didaktike

- ✚ **Objektiv 2)** Hartimi i kurrikulës lëndore (kl 0 -5), përgatitja e 50 moduleve trajnuese për kurrikulën e rishikuar, të 10 moduleve për nxënësit me aftësi të kufizuara (AK). Trajnimi i mësueseve të AB dhe të diasporës (70 mesues) për zbatimin cilësor të kurrikulës 25 % e mesuesve të AB.
- ✚ Përmirësimi i cilësisë së teksteve shkollore dhe kompensimi 100% nga klasa I-IX për nxënësit rom, egjiptiane, fëmijëve që gëzojnë statusin ligjor të jetimit, fëmijëve që gëzojnë statusin e të verbrit, fëmijëve të pakicave kombëtare, fëmijëve të familjeve të emigrantëve që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, fëmijëve që vijnë nga familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie; fëmijë të familjeve që kanë në përbërjen e tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, fëmijë që vijnë nga familje ku kryefamiljari përfiton pension pleqërie shteti dhe kanë fëmijë në ngarkim, të cilët janë pa të ardhura; familje në nevojë 4000 nxënës.
- ✚ **Objektiv 3)** Sigurimi i një arsimit cilësor për fëmijët në nevojë, (rritja e treguesit të regjistrimit me 4% ose 160 fëmijë për nxënësit romë dhe egjiptianë, 2% për nxënësit me AK. Rritja me 1.5 % e numrit të mësuesve asistent për nxënësit me AK. Sigurimi i transportit të nxënësve për ndjekjen e AB. Uljen e braktisjes shkollore në AB në 0.3%. Trajtimi i diferencuar i mësuesve (20-25%) që, do të punojnë me fëmijët që kanë braktisur shkollën për riintegrimin e tyre.
- ✚ **Objektiv 4)** Konsolidimi i shërbimit psiko-social nëpërmjet ngritjes së njësive të shërbimit psiko-social në njësitë arsimore vendore. Tranimit i vazhdueshëm i psikologëve (150) dhe punonjësve socialë (150). Ngritja e mekanizmit të supervizimit të shërbimit psiko-social dhe e kapaciteteve të tyre. Modernizimit i kabineteve të shërbimit psiko-social (kompjuter, printer, telefon) dhe pajisja me instrumentet e punës (teste vlerësimi, dosje individuale për çdo nxënës, manuale pune)
- ✚ **Objektiv 5)** Arsimit cilësor e gjithëpërfshirës me synim plotësimin e standardeve Europiane: ndërtime të reja e rihabilitim të objekteve arsimore 450 - 500 klasa e sigurimi i pajisjes së tyre. Pajisja e 20-25% të shkollave të AB me laborator shkencorë, IT synimi një kompjuter për dy nxënës në orë mësimi, laboratorë virtual e biblioteka dixhitale në AB (të paktën 1 set laptop-projektor për çdo shkollë).

Arritje për vitin 2014

- ✚ **Arsimimi në fëmijërinë e hershme.** Në Shqipëri, 76% e fëmijëve të grup moshës 3-5 vjeç (treguesi NER) dhe 83% fëmijëve 3-6 vjeçarë (treguesi GER), ndjekin institucionet parashkollore (Instat 2012-2013). Në vitin shkollor 2013-2014 numri total i fëmijëve 3-6 vjeçarë në kopshte ishte 81 448, nga të cilët 76 416 ose 94 % frekuentonin kopshtet publike dhe 5 032 ose 6% fëmijë ato private. 610 fëmijë romë kanë ndjekur arsimin parashkollor; Ndërsa 195 720 nxënës ndoqën arsimin fillor, nga të cilët 94 % arsimin publik . Pranë shkollave të arsimit bazë u ngritën dhe funksionuan rreth 448 klasa përgatitore me 11 047 nxënës 5-vjeçarë, pra 63 klasa (ose 14 %) më shumë se një vit më parë ,ku u punësuan 63 mësues dhe 1 547 (ose 14 %) nxënës më shumë dhe se një vit më parë. Klasat përgatitore u ndoqën nga 136 fëmijë romë ose 66% më shumë se një vit më parë.
- ✚ Është planifikuar dhe po përgatitet përfshirja graduale e klasës përgatitore në arsimin e detyruar **Është hartuar dhe filloi pilotimi I paketës së re kurrikulare për klasën përgatitore** dhe klasën e parë të arsimit fillor. Paketa e re kurrikulare e cila përshin kornizën, kurrikulën bërthamë, programet dhe fushat e të nxënimit do të pilotohet në 26 klasa përgatitore dhe të para, nga ku do të përfitojnë rreth 780 nxënës.
- ✚ **Arsimi gjithëpërfshirës.** Gjatë vitit shkollor 2013-2014 e ndoqën arsimin parauniversitar 4 219 fëmijë romë, 134 më shumë në krahasim me vitin shkollor 2012-2013. Për herë të parë, u identifikuan 93 mësues romë dhe egjiptianë të diplomuar për mësuesi, prej të cilëve janë punësuar në sistem 86% e tyre (80 mësues): 10 në arsimin parashkollor, 21 në klasat I-V; 35 në klasat VI-IX (1 egjiptian drejtor shkolle në Dibër) dhe 14 në arsimin e mesëm të lartë. Të 35 mësuesit romë janë të punësuar sipas profilit të diplomës që zotërojnë.
- ✚ **“Çdo fëmijë në shkollë”.** Në vitin 2014 është nënshkruar marrëveshjen me MMSR, MPB dhe MSH për të regjistruar në klasë të parë çdo fëmijë pa përjashtim, përmes projektit të mbështetur nga UNICEF “Çdo fëmijë në shkollë”.
- ✚ **“Çdo fëmijë rom në kopsht”** në vijim të synimeve dhe objektivave të MAS, si dhe me mbështetjen e UNICEF, kemi prezantuar dhe do të mbështesim zbatimin e nismës.

- ✚ **Mësim në qëndrn spitalore universitare**, për herë të parë në muajin mars të këtij viti, si rezultat i bashkëpunimit të MAS me QSUT-në “Nënë Tereza”, filloi ofrimi i shërbimit arsimor, nga dy mësuese të caktuara prej DAR-së së Qytetit Tiranë , **për fëmijët e shtruar në repartet e ndryshme të pediatriisë**, në mënyrë që këta fëmijë të ndjekin mësimet e klasës që i përkasin dhe të mos kenë prapambetje kur të kthehen në shkollë pas daljes nga spitali.
- ✚ **“Edukimi në strehëzën tënde”**, MAS ka miratuar projektin e paraqitur nga Shkolla e Lartë “Bedër” përmes të cilit, që në shtator të këtij viti do t’u ofrohet fëmijëve të ngjuar mundësia për t’u arsimuar nëpërmjet zbatimit të paketave mësimore digjitale bashkëkohore.
- ✚ **Tekstet shkollore** Për herë të parë, u realizua tërheqja masive e mendimit të mësuesve, komunitetit të prindërve dhe grupeve të tjera të interesit lidhur me vlerat dhe problematikat që ka e gjithë gama e teksteve shkollore të arsimit parauniversitar në përdorim. Në përfundim, u administruan vërejtje të detajuara të natyrës shkencore, gjuhësore dhe metodike. MAS u kërkoi botuesve përkatës të ndreqin vërejtjet dhe t’i reflektojnë ato në rishtypjet për vitin shkollor 2014–2015. Si rezultat i punës së bërë u arrit që numri i titujve që do të përdoren në vitin shkollor 2014–2015, **të ulet me 120, krahasuar me numrin e titujve që përmbante katalogu i vitit shkollor 2013–2014**. Procesi i mësipërm zbuloi dhe shtroi si domosdoshmëri reformimin e krejt sistemit të deritanishëm të sigurimit të teksteve të arsimit parauniversitar.
- ✚ **Pilotimi i kurrikulës së re**. Në kuadër të rishikimit të kurrikulës së arsimit parauniversitar u hartua korniza kurrikulare dhe Kurrikula përkatës. Kurrikula e re pilotohet në 26 shkolla 9 vjeçare pranë DAR-eve. Në vitin shkollor 2014-2015 filloi zbatimi i kurrikulës së re në çdo DAR. Janë përfshirë një shkollë në qytet dhe një në fshat. Në pilotim janë përfshirë 500 mësues të cilët janë trajnuar për kurrikulën e re në korrik dhe shtator 2014. Këta mësues do të shërbejnë si bërthamë për trajnimin e mësuesve të tjerë që priten të përfshihen në pilotim. Pilotimi realizohet për klasën përgatitore, klasën e parë dhe klasën e gjashtë. DAP koordinon dhe monitoron këtë proces. Hartimi i kornizës së re kurrikulare të arsimit parauniversitar (K-9) dhe unifikimi i kësaj kornize me KK të Kosovës. Për hartimin dhe **pilotimin e kurrikulës së re janë kryer këto aktivitete;**
 - a) Hartimi i Kurrikulave Bërthamë për klasat 1/5 dhe 6/9
 - b) Hartimi i programit të klasës përgatitore
 - c) Hartimi I programeve të klasave 1-9, sipas çdo lënde.
 - d) Janë përzgjedhur 26 shkolla për çdo DAR një shkollë në qytet e një në fshat. Në çdo shkollë qyteti një klasë përgatitore, 2 klasa të para dhe 2 të gjashta. Në çdo shkollë fshati një klasë përgatitore, një klasë e parë dhe një e gjashtë
 - e) Nr i mësuesve të cilët kanë marrë trajnim është 500 mësues Mësuesit kanë marrë rreth 7 ditë trajnim
- ✚ Faza 1 qershor 2014: 500 mësues janë trajnuar nga stafi i IZHA në Tiranë (temat KK, KB)
- ✚ Faza 2 Korrik 2014: 500 mësues janë trajnuar nga stafi i IZHA në Shkodër, Fier, Kukës, Korçë dhe Tiranë. (trajnim mbi programet sipas profileve të çdo mësuesi)
- ✚ Faza 3. Shtator 2014 500 mësues janë trajnuar nga stafi i IZHA në Shkodër, Fier, Kukës, Korçë dhe Tiranë. (trajnim mbi vlerësimin e kurrikulës dhe formatet e planifikimit)

Zhvillimi profesional i mësuesve Sipas planit vjetor të IZHA-s kualifikimi i mësuese ka kaluar etapat e përgatitjes së testeve, procesin e provimit më datë 3 maj dhe korrigjimin e tyre.

U përgatitën testet për atestim , ju nënshtruan provimit të atestimit 3500 mësues. u korrigjuan teste Brenda afateve të përcaktuara nga MAS, u prodhuan certifikatat (prokurim), u analizuan rezultatet.

- ✚ **Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara** . Arsimimi I fëmijëve me aftësi të kufizuara realizohet në disa forma: Në institucione të veçanta siç janë institutet kombëtare. Në klasa të veçanta brenda shkollave 9-vjeçare. Në “Qendra ditore”, të specializuara; Në kopshte dhe klasa normale të arsimit bazë, ku ka të integruar përkatësisht 320 dhe 2000 fëmijë më AK. Politikat e arsimit gjithëpërfshirës që zbaton MAS, synojnë që krahas edukimit dhe arsimimit të arrihet edhe rehabilitimi maksimal I mundshëm I fëmijëve më AK . Është realizuar baza e të dhënave për fëmijët me aftësi të kufizuara në arsimin parashkollor dhe bazë. MAS në bashkëpunim me “Save the Children”, UNICEF dhe partnerë të tjerë : Ka përfunduar studimin

kombëtar analitik *“Situata e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e arsimit 9-vjeçar”* për vitin 2011-2012, nga ku rezulton se: 511 ose 22% e fëmijëve më me AK të moshës 3-6 vjec ndjekin kopshtet normale dhe 3167 ose 58% e fëmijëve me AK të grupmoshës përkatëse ndjekin shkolla normale të arsimit bazë. Po harton kurrikulën e programit trajnues bazë për aftësinë e kufizuar, për mësuesit në shërbim. Në cdo DAR/ZA janë ngritur dhe funksionojnë Komisionet Multidisiplinare të vëlërësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Teknologjia e informacionit dhe komunikimit Synimi: Mbështetja e procesit të të nxënësve për të gjithë duke integruar në mënyrë efektive dhe cilësore teknologjinë e informacionit dhe komunikimit në të gjitha nivelet arsimore, duke i kushtuar vëmendje të veçantë zhvillimit të kurrikulave me fokus në sigurinë e nxënësve nga interneti, si dhe zhvillimin e kompetencave digjitale.

- U integrua TIK në të gjitha nivelet arsimore;
- U hartua udhëzuesi për zbatimin e standardeve të TIK-ut në shkollë, për drejtuesit dhe mësuesit.
- Zhvillimi profesional i mësuesve për zbatimin e standardeve të TIK-ut në shkollë.
- Ndërtimi i orëve interaktive në kurrikulën e gjimnazit në lëndët bazë të kësaj kurrikule.

Fondet e rishikuara për këtë program për vitin 2014, janë në masën **26.1 miliard lekë**. Fondet e programit të arsimit bazë të arrijnë 61.4 % e fondeve të MAS, për periudhën 12-mujore realizimi i fondeve është në masën 25.1 miliard lekë ose në 96% e fondeve të planifikuara të programit. Fondet e arsimit bazë zënë rreth 61.5% të totalit të shpenzimeve të realizuara për periudhën 12-mujore për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Në strukturën totale buxhetit, fondet i arsimit bazë *pa u përfshirë shpenzimet e njësisve të qeverisjes vendore* arrijnë në 5.61% ndaj shpenzimeve publike, ose 1.73% të PBB.

Për vitin 2014 në grupin e shpenzimeve për personelin janë miratuar **22 miliard e 239 milion lekë** për mbulimin e pagave dhe të sigurimeve shoqërore për rreth 29 817 punonjësve të arsimit 9-vjeçar, të cilët ofrojnë shërbime arsimore rreth **78,416 fëmijëve** që ndjekin arsimin parashkollor, si dhe për rreth **356,347 nxënës** në arsimin 9-vjeçar. Fondet për shpenzime personeli për periudhën 12-mujore janë realizuar në shumën e **21 miliard 634 milion lekë** ose në masën 98% ndaj planit të miratuar për vitin 2014

Për vitin 2014, në programin e arsimit bazë u siguruan kushte për kryerjen e praktikës profesionale për rreth **1200 praktikantë konform VKM nr.231**, datë 23.4.2014 *“Për përcaktimin e numrit të praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale, me kontratë të përkohshme, për periudhat 1 janar - 15 qershor 2014 dhe 15 shtator - 31 dhjetor 2014, për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit”*.

Fonde buxhetore për krijimin e kushteve të punës të planifikuara për vitin 2014, në artikullin (602-606) janë parashikuar **910 milion lekë, buxheti i rishikuar** për periudhën 12-mujore 2014 në këtë program është në masën 1 miliard e 457 milion lekë, **realizimi vjetor** shpenzimeve korente 602-606 është në masën 1 miliard e 399 milion lekë ose në masën 97% e planit të rishikuar. **Fonde buxhetore** të miratuara në këtë program mbulojnë shpenzimet për ofrimin e shërbimeve arsimore për rreth **78 416 fëmijë në arsimin parashkollor, si dhe 356 347 nxënës në arsimin 9-të vjeçar**, më të detajuara si më poshtë vijon;

- a) **Fondet për mbulimin e shpenzimeve të transportit** *“Për transportin 31 197 nxënësve që kanë vendbanimi mbi 2 km nga shkolla si dhe transportin e 11 128 mësuesve që punojnë mbi 5 Km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë”*, janë planifikuar detajuar 550 milion lekë mbështetur në të dhënat analitike të dërguar nga për cdo DAR/Za, si dhe analizën aktuale të cdo institucioni, për këtë periudhë janë realizuar **523 milion lekë**.

Theksojmë se gjatë vitin 2014 në zbatim të VKM nr. 50/2014, janë likuiduar dhe **39.1 milion lekë** detyrime për transportin nga viti 2013.

- b) **Fonde buxhetore për të mbuluar shpenzimet e bursave** për 322 nxënës romë dhe egjiptianë me afro 4.2 milion lekë në vit.

- c) **Fonde buxhetore për të mbuluar shpenzimet për institucionet special** për nxënësit që nuk dëgjojnë dhe nxënësit nuk shikojnë për rreth 220 nxënës që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë me afro janë planifikuar 111.6 milion lekë dhe janë realizuar 105.8 milion lekë në vit ose rreth 95%.
- d) **Fonde për shërbimin e internetin në shkollat e arsimit 9-vjecar, janë parashikuar për vitin 2014 rreth 50 milion lekë (vetëm për periudhën** pas përfundimit të kontratës me Albtelekom si dhe përcaktimit të numrit të shkollave që nuk do të përfitojnë internet nga “Posta Shqiptare”) është realizuar vetëm një muaj shërbim pasi kontrata është lidhur në muajin nënëtor 2014. Në vitin 2014 janë mbuluar si detyrime për shpenzime internet 2012-2013 shuma prej 180 milion lekë, nga të cilat 171.6 milion lekë detyrime nga viti 2012-2013
- e) Shpenzime për trajnime të mësuesve në DAR, që punojnë me nxënës nga shtresat e marxhinalizuara, si dhe uljen e braktisjes **8.6 milion lekë;**
- f) Shpenzime për blerje dokumentacion shkollor DAR/ZA, **janë planifikuar 10 milion lekë,** janë realizuar me sukses procedurat dhe janë likuiduar 5 milion lekë, pjesa tjetër do të likujdohet në vitin 2015.
- g) Shpenzime për blerjen e teksteve shkollore për fëmijët në diasporë **3.5 milion lekë i rishikuar 12 milion lekë, nuk janë realizuar me sukses procedurat e prokurimit.**
- h) Shpenzime për blerje pulla me hologram **janë planifikuar dhe realizuar 3.5 milion lekë,** janë realizuar procedurat dhe janë likuiduar 1.95 milion lekë.
- i) **Fonde buxhetore për të mbuluar shpenzimet për transfertat tek individët për blerjen e tekstet shkollore,** në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 10.2.2010 “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore, të sistemit arsimor parauniversitar”, të ndryshuar vendimin nr. 212 datë 16.3.2011 si dhe shperblime nga fondi i vecante për raste ndihme hospitalore si dhe raste vdekje në familje. **Për vitin 2013** u planifikuan dhe realizuan rreth 245 milion lekë, për rreth **93 756 nxënës përfitues nga shtresat sociale në nevojë,** tekstet për nxënës në diasporë, nga të cilët **3 063 nxënës romë,** si dhe për nxënësit që nuk shikojnë, duke përfshirë dhe rimbursimin e teksteve të minoriteteve, të cilat u rimbursuan nëpërmjet bankave të nivelit të dytë si dhe postës shqiptare **Për vitin 2014,** pagesa e teksteve janë planifikuar 240 milion lekë pas plotësimit të procedurave për dhënin e falas nxënës përfitues nga shtresat sociale në nevojë, tekstet për nxënës në diasporë, nxënës romë, si dhe për nxënësit që nuk shikojnë, duke përfshirë dhe rimbursimin e teksteve të minoriteteve, sipas raportimeve për vitin 2014 **janë realizuar 207.3 milion lekë duke përfituar 73 709 nxënës.**
- j) **Për herë të parë në vitin 2014,** janë dhënë shpërblim për **5 993 nxënës me 5 000 lekë** duke përfituar rreth 30 milion lekë, si dhe shpërblimi për 549 mësues me arritje të larta për vitin 2014 me 40 000 lekë për çdo mësues me një efekt financiar prej 21.9 milion lekë.

Në total në grupartikullin e *shpenzimeve operative* artikulli 602-606, buxheti i rishikuar 1 miliard e 457 milion lekë dhe për periudhën 12-mujore 2014 janë realizuar në shumën 1 miliard e 399 milion lekë ose në masën 97%.

Shpenzimet për investime kapitale në programin Arsimit Bazë, janë 2 miliard e 440 milion lekë nga të cilat, janë financim i brendshëm ose 100% .Sipas projekteve prioritare paraqiten:

Investime pjesë e fondit të zhvillimit të rajoneve detyrime nga viti 2012-2013, si dhe si dhe të miratuara në vitin 2014, arrijnë në shumën prej rreth **2 miliard 440 milion lekë,** nga të cilat;

1. Janë financuar me përparësi **74 objekte arsimore,** me një vlerë prej 1 miliard e 560 milion lekë për ndërtime dhe rikonstruksionine, objekte të miratuara me FZHR 2014, nga të cilat:

- + **60 objekte arsimore në arsimin bazë** të miratuara me Vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve në Korrik 2014 (thirrje I+ thirrje II)
- + **46 terrene sportive në 12 NJQV** në qarqet kryesore të vendit, me vlerë rreth 150 milion lekë,
- + **Për vitin 2014** janë financuar gjithashtu rreth 96 projekte/kontrata / objekte në vazhdim nga viti 2009-2013 me rreth **1.3 miliard lekë,** nga të cilat 80 kontrata janë financuar 100% dhe objektet/ kontrata kanë përfundua.

- ✓ **Janë financiar për pajisje mobilierie** për afro 60 objekte arsimore që përfundojnë punimet dhe kërkohet furnizim 100 milion lekë, kontrata është realizuar 100%.
- ✓ **Janë miratuar 15 milion lekë** “Për Krijimin e fondit për bibliotekat shkollore në asrimin bazë”, deri tani nuk janë realizuara procedurat.
- ✓

Realizimi i shpenzimeve kapitale për 12 mujorin 2014 në këtë program është **2 miliard e 102 milion lekë** ose **86 %** të buxhetit të planifikuar.

Në total realizimi i fondeve për 12- mujorin 2014 në këtë program është realizuar në masën **96 %** dhe përfaqëson rreth **61.5 %** të fondeve të arsimit të realizuara të fondeve të MAS.

Sipas grup artikujve të dhënat janë sa vijon;

Shpenzimet korente	97 %
<u>Shpenzimet kapitale</u>	<u>86 %</u>
Gjithsej	96 %

Në këtë program janë parashikuar për t’u realizuar produktet e mëposhtem, ecuria e të cileve krahasuar me planin vjetor paraqitet në tabelën në vijim

		Në mijë lekë			
Kodi i		Buxheti Vjetor 2014	Buxheti Rishikuar 2014	Fakti 12- mujor 2014	Realiz ne %
Produktit	Emri i Produktit				
A	Pajisje mobilierie per kabinetet e informatikes	16,000	0	0	0%
A	Kabinete te mobiluara te lendeve kimi fizike biologji	10,000	0	0	0%
A	Furnizimi me pajisje mobilierie i shkollave dhe kopshteve te reja dhe te rehabilituara	74,000	100,000	100,000	100%
A	Bibloteka shkollore te krijuara sipas standardeve	15,000	0	0	0%
A	Reabilitimi i kopshteve dhe shkollave per rritjen e aksesit të fëmijëve 5 vjeçar me 10% dhe fëmijëve 3-4 vjeçarë	1,357,278	2,012,790	1,694,360	84%
A	Ndertimi i shkollave/kopshteve te reja	327,722	327,722	307,897	94%
A	Konsolidimi i Sherbimit arsimor ne sistemin PARASHKOLLOR ,e realizimin e funksioneve te edukimit	3,100,960	3,100,960	3,023,436	98%
B	Realizimi i sherbimit arsimor ne sistemin 9 vjecar, per permbushjen e funksioneve te edukimit dhe realizimin e misionit te edukimit.	19,059,711	19,600,094	19,066,267	97%
C	Pilotimi i kurrikulës së re në klasat 1-9 do të jetë i planifikuar, koherent, dhe gjithëpërfshirës dhe do të ndërtohet mbi bazën e partneritetit	37,416	41,130	39,616	96%
D	Trajnimi i mësuesve te arsimit baze, per implementimin e kurikulave e programeve mesimore, rritjen e kompetencave profesionale	28,000	23,027	21,600	94%
E	Zhvillim i reformes se teksteve shkollore për AB, si dhe kompesimi i nxenesve te shtresat sociale ne nevojë	246,000	246,000	207,300	84%
F	Zhvillimi i programit "Shkolla Komunitare" ne sistemin arsimor per permbushjen e funksioneve te edukimit dhe realizimin e misionit te edukimit.	4,800	4,800	4,800	100%
G	Sherbim transporti per nxenes e mesues qe punojne mbi 5 km nga vend banimi i tyre dhe të nxënësve që punojnë e mësojnë mbi 2km jashtë vendbanimit.	560,000	562,100	562,100	100%
H	Sigurimi i një arsimit cilësor për fëmijët në nevojë, (rritja e treguesit të regjistrimit me 4% ose 160 femije për nxënësit romë dhe egjiptianë, 2% për nxënësit me AK (Insti qe nuk Shikojne , Nuk degjojne, Luigj Gurakuqi , etj)	113,113	118,086	108,462	92%
		24,950,000	26,136,709	25,135,838	96%
	Shpenzime jashte buxhetore	0	14,183	14,183	100%
	TOTALI	24,950,000	26,150,892	25,150,020	96%

Nga tabela e mësipërme del që disa produkte nuk janë realizuar për 12-mujorit 2014;

1. Fondet “Për Krijimin e fondit për bibliotekat shkollore në asrimin bazë”, nuk janë realizuar procedurat e prokurimit për lidhjen e kontratës.

Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit për 12- mujorin 2014:

1. Vendimarrja me vonesë e komitetit për Zhvillimine Rajoneve, për fondet e zhvillimin e rajoneve 2014, nuk janë realizuar vetëm ato fonde që janë miratuar me thirrjen nr. I dhe thirrjen nr. II Gusht 2014.
2. Në kuadër të likuidimit të detyrimeve për vitin 2012-2013 u realizuan fondet si pasojë e mangësive në dokumentacionin e paraqitur nga firma kontraktore.

3. Kufizime buxhetore nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Borxhit dhe Thesarit pasi ende nuk janë likuiduar detyrimet e konfirmuara nga firma kontraktore, degët e tatimeve, degët e thesarit si dhe MAS prej muajit korrik 2014 vijon auditimi i detyrimeve të mbartura nga 2012-2013.

III - ARSIMI I MESËM I PËRGJITHSHËM. (Titulli i programit 09230)

Objektivat kryesore:

Objektiv 1). Rritja e mëtejshme e cilësisë së mësimdhënies, me qëllim që, deri në vitin 2018 të perafrohemi standardet e vendeve të BE Përmirësimi i standardeve të infrastrukturës në gjimnaze, 8-10% e klasave ndaj totalit ekzistues do të rehabilitohen, 5%-8% e klasave ndërtohen të reja, 8-10 % e shkollave do të pajisen me laborator shkencor

Objektiv 2). AMP ta ndjekin 75% e nxënësve që përfundojnë arsimin bazë, ndërsa 25% ndjekin arsimin profesional. Shtimi i laboratorëve të TIK si dhe shtrirja në vazhdim e internetit në shkollat e arsimit të mesëm të mesëm të përgjithshëm. Pajisja me laboratorë virtuale e rreth 15% të shkollave të mesme të përgjithshme për çdo vit. Pasurimi i bibliotekave në të gjitha shkollat.

Objektiv 3). Trajnimi i 10-15% e punonjësve mësimorë, për zbatimin kurikulës së gjimnazit.

Objektiv 4). Krijimi i kushteve për realizimin e matures shtetërore për afro 40-42 mijë maturanë, hartimi i testeve për provimeve, procesi i dhënies së provimeve, vlerësimeve të provimeve, deri në shpalljen e rezultateve.

Arritje 2014

✚ Në vitin shkollor 2014/2015, rreth 92% e nxënësve që përfunduan arsimin e detyruar u regjistruan në arsimin e mesëm, çka tregon se objektivi i kësaj qeverie, sipas të cilit çdo nxënës që përfundon arsimin e detyruar duhet të ketë mundësi reale për të vijuar arsimin e mesëm, është realist dhe në rrugë të mbarë të realizimit të tij Për vitin 2013-2014 në **arsimin e mesëm të përgjithshëm** u siguruan kushte dhe shërbim arsimor për rreth **104 308** nxënës.

✚ Në **arsimin e mesëm të përgjithshëm**, vazhdon konsolidimi i cilësisë së Maturës Shtetërore, e cila konsiston në 4 provime për rreth 42 - 45 mijë maturantë (2 provime të detyruara dhe 2 provime me zgjedhje). Matura shtetërore dhe provimet e lirimit 2014. Në tërësinë e organizimit dhe administrimit, Matura Shtetërore shënoi një standard të ri në realizimin e përgjegjësisë publike që Ministria e Arsimit dhe Sportit ka për cilësinë e shërbimit arsimor. MAS, ashtu siç ishte angazhuar dhe siç u kishte premtuar qytetarëve, arriti të realizojë Maturën Shtetërore si një maturë të besueshme.

✚ **Provimet e MSh** shënuan një standard të ri të komunikimit dhe bashkëpunimit të MAS-it me njësitë bazë të qeverisjes vendore, me institucionet e arsimit të lartë, me Ministrinë e Punëve të Brendshme, me Postën Shqiptare dhe, sigurisht, me DAR/ZA-të dhe shkollat. Promovimin dhe njohjen e nxënësve me masat dhe risitë e Maturës Shtetërore. Zhvillimin e provimeve në qendra dhe mjedise të përshtatshme të provimit, të cilat lehtësuan miradministrimin e tyre në të dy sesionet.

Administrimin e provimet të MSh nga një trupë administruese e mirë trajnuar. Përzgjedhjen e testeve të provimeve të Maturës Shtetërore përmes teknologjisë digjitale, duke sjellë siguri dhe cilësi në hartimin e testit. Testet u hartuan mbi tri nivele vështirësie: i ulët, i mesëm dhe i lartë.

Rritjen e transparencës së cilësisë së arritjeve. Përcaktimi para korigjimit i kufirit për të marrë notë kaluese (cut off) 20% të pikëve. Monitorimin rigoroz dhe të dubluar të provimeve (nga DAR/ZA dhe MAS). Funkcionimin e organeve dhe strukturave të Maturës Shtetërore në nivel shkolle dhe DAR/ZA-je. Futja e gjuhës së huaj si provim i detyruar i MSh. Njësimi i rreth 1000 diplomave të shtetasve të huaj dhe shqiptare të cilët dëshirojnë të studiojnë në IAL Shqiptare.

✚ Në **kurrikulën e arsimit të mesëm të përgjithshëm** është shtuar si lëndë me zgjedhje këtë vit, lënda “Financat Personale”, e cila realizohet në bashkëpunim me Bankën Qëndrore të Shqipërisë që ofron ekspertizën dhe trajnon mësuesit përkatës në shkollat e mesme. Është aktualisht në proces përgatitja e

programit modular për lëndën e Sipërmarrjes përfshirë në kurrikulën me zgjedhje të arsimit të mesëm, në funksion të përgatitjes për tregun e punës.

- ✚ **Shkolla Qendër Komunitare “Shkolla qendër komunitare - një shkollë miqësore për të gjithë”** është nismë që synon përmirësimin e cilësisë së punës dhe jetës në shkollë duke e kthyer atë në vendin ku ndërtohet partneriteti shkollë-familje-komunitet, përtej orëve të mësimin. Nisma, në vitin shkollor 2013-2014 **u shtri në 66 shkolla në shkallë vendi – 35 në arsimin bazë dhe 31 në arsimin e mesëm** dhe atë profesional. Nisma mbështetet mbi standarde të miratuara nga MAS. Ajo është e koordinuar në të gjitha nivelet. Nisma mbështetet nga institucione dhe organizata , partnerë të MAS në këtë nismë si Këshilli Europës, UNICEF, Korpusi Paqes, Eorld Vision, Fondi shqiptaro-amerikan për zhvillim, Save the Children, Këshilli Britanik, Terre Des Homme etj. DAR/ZA dhe shkollat pjesë të kësaj nisme per vitin shkollor 2013-2014 realizuan: Veprimtari në kuadrin e gjithëpërfshirjes në arsim, me komunitetin rom, fëmijët me aftësi të kufizuara, shërbim psikologjik.
- ✚ Veprimtari sportive te gjitha llojeve te sporteve ne mjediset aktuale por dhe ne veprimtari rajonale apo te pushtetit vendor.Veprimtari kulturore, artistike. Bibliotekat ne funksion të të gjithëve Veprimtari për mbrojtjen e mjedisit
- ✚ Në këto veprimtari janë përfshirë një numër i konsiderueshëm nxënësish, mësuesish dhe prindërit. Tre qarqet që patëm përfshirjen më të madhe në këtë nisëm ishin;

	Nr. mësuesve	Nr. nxënësve, arsim bazë	nxënës në arsimin e mesëm, profesional	Nr.prindërve
DAR Berat	2240	2630	4583	280
DAR Lezhë	120	1511	931	1250
DAR Durrës	351	4000	4321	1623

Në vitin shkollor 2014-2015 u zgjerua numri i shkollave të përfshira në iniciativën Shkolla Qendra Komunitare, sot kemi 162 shkolla nga 150 të synuara si rezultat i rishikimit të hartës shkollore pjesëmarrëse në këtë nismë. Numri i shkollave është rritur përafërsisht në çdo DAR/ZA rreth 11 shkolla në total.

- ✚ **Mbështetje rajonale për arsimin gjithpërfshires**, në muajin shtator 2014 shkollave ju është shpërndarë udhëzuesi i përgatitur për këtë qëllim nga ekspertë të IZHA-s. 7 shkolla pjese e projektit rajonal “**Mbështetje rajonale për arsimin gjithpërfshires**” tashmë edhe pjese e këtij projekti kane përfituar grante shkollore nga Bashkimi Europian dhe Këshilli Evropës për projekte te hartuara ne ketë fushe. Përmes këtij projekti një rëndësi përparësore do ti jepet arsimit te mesëm dhe atij profesional.U realizua financimi i mësuesve të cilët do të japin kontribut në këtë nisme.
- ✚ **Hartimi i kurrikulës së re të arsimit 9-vjeçar**, rreth 80 mësues dhe pedagogë, nga më të mirët e vendit, punuan me përkushtim dhe përgjegjësi në përbërje të grupeve të programeve lëndore dhe grupit qendror për hartimi i kurrikulës së re të arsimit 9-vjeçar, e cila mbështetet në traditën e arsimit tonë kombëtar dhe në përvojën e vendeve më të suksesshme në arsim. Kjo paketë është në fazën e diskutimit përfundimtar dhe së shpejti miratohet.
- ✚ **Gjatë vitit 2014, Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP)** organizoi Provimin e Shtetit për degët Mjekësi dhe Farmaci etj, nëpërmjet teknologjisë dixhitale dhe në përputhje me standartet evropiane. Sesiioni i parë i provimit të shtetit përfundoi me sukses të plotë dhe fitoi një besueshmëri të lartë tek publiku. Për herë të parë në Shqipëri u zhvillua dhe implementua një standard i mirëfilltë ndërkombëtar i provimit tërësisht dixhital, me zero korrupsion dhe transparencë maksimale.
- ✚ **Për vitin 2014 në programin e arsimit të mesëm, u siguruan kushte për kryerjen e praktikës profesionale për rreth 300 praktikantë konform VKM nr.231, datë 23.4.2014**“Për përcaktimin e numrit të praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale, me kontratë të përkohshme, për periudhat 1 janar - 15 qershor 2014 dhe 15 shtator - 31 dhjetor 2014, për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit”. Rregullorja mbi “Organizimin dhe Zhvillimin e Praktikave Profesionale për Profesionin e Rregulluar të Mësuesit” Nr. 3874, datë 14.07.2011 **miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit** si dhe **programi i praktikës profesionale për mësuesit e rinj**, të cilët do t’i nënshtrohen provimit të shtetit, në mënyrë që të kualifikohen si mësues të licencuar. Sipas kësaj Rregulloreje, mësuesit e diplomuar në shkollat tona të larta do të mundën ta ushtrorjnë profesionin e mësuesit vetëm pasi t’i nënshtrohen

praktikës profesionale njëvjeçare të cilët janë mësues që përmbushin kritere të caktuara, dhe pasi t'i jenë nënshtruar provimit të shtetit.

✚ **Për herë të parë në vitin 2014**, janë dhënë shpërblim për **886 nxënës me 5 000 lekë** duke përfituar rreth 4.4 milion lekë.

✚ **Sfida kryesore në arsimin e mesëm të përgjithshëm vazhdon të mbetet cilësia me standarte bashkohore**, dhe përafrimi i kurrikulës së klasës 10-12 në përputhje me tregun e punës.

Buxheti i miratuar për programin e arsimit të mesëm të përgjithshëm për vitin 2014 është në vlerën **5 miliard e 998.2 milion lekë me 15.4%** të buxhetit të MAS. Fondet e buxhetit të rishikuar për vitin 2014 arrijnë në vlerën **6 miliard e 559.8 milion lekë me 14%** të buxhetit të MAS.

Realizimi i shpenzimeve për 12- mujin 2014 në këtë program është në masën **6 miliard e 148 milion lekë** ose në masën **94 %** dhe përfaqëson rreth **13.7 %** të fondeve të realizuara për MAS.

- a) **Fondet për shpenzime personeli, ku përfshihen pagat dhe sigurimet shoqërore**, janë **5 miliard e 25 milion lekë** për 6095 punonjës nga të cilët 5 408 punonjës mësimore dhe 687 punonjës ndihmës për shërbime mbështetëse, ku përfitues të shërbimit arsimor janë rreth **104 308 nxënës** ve në arsimin e mesëm (gjimnazet), realizimi 12-mujor është në masën **4 miliard e 888 milion lekë** ose në masën **98%**.
- b) **Shpenzime operative** në artikullin **602- 606**, janë **planifikuar 221.4 milion lekë** ose **4.2%** e shpenzimeve korente, buxhti i rishikuar është në masën 263.3 milion lekë, realizimi i shpenzimeve për periudhën 12- mujore është në masën **230.2 milion lekë** ose **87.5%** ku përfshihen;
 - Shpenzime për DAR/ZA shpenzime për transportin e mësuesve dhe për blerje mjetet didaktike e materiale të tjera mësimore në vlerën **80 milion lekë**,
 - Shpenzime për trajnime personeli e të ngjashme – **20 milion lekë**,
 - Shpenzime për AKP - **119** milion lekë, shpenzime për aktivitete për maturën shtetërore 2014, si dhe provimet e shtetit janë realizuar **115.6 milion lekë** ose **97.2%** e fondeve të planifikuara .
 - Shpenzime për blerje dokumentacion shkollor regjista, amza, deftesa, **3 milion lekë**, për vitin 2014
 - Shpenzime për të mbuluar aktivitete ekstrakurrikulare, olimpiada kombëtare apo ndërkombëtare, konferenca në MAS, **2.5 milion lekë**
 - **Shpenzime për në artikullin 606**, - Kompesimi i blerjes së teksteve shkollore për të gjithë nxënësit e familjeve që marrin ndihmë sociale **71.4 milion lekë**, ku parashikohet të përfitojnë ribursim rreth 15,890 nxënës.
- c) **Fondet për investime kapitale në programin Arsimit Mesëm të Përgjithshëm**, janë 1 miliard 271 milion lekë lekë, 100% me financim të brendshëm. Realizimi i shpenzimeve kapitale për 12- mujin 2014 në këtë program është 1 miliard e 30 milion lekë ose 81%, sipas projekteve kryesore paraqiten:
 1. **Janë financuar 42 objekte/projekte, ndërtime të reja, si dhe shtesa objektsh shkollorë** në vazhdim nga viti 2012-2013 si dhe të miratuara në FZHR 2014 me vlerë financimi **671** milion lekë, realizimi 12-mujor është 583 milion lekë ose në masën 87%.
 2. **Janë financuar për pajisje mobilierie** për afro **30 objekte arsimore** që përfundojnë punimet dhe kërkohet furnizim 52 milion lekë, kontrata është realizuara 100% brenda vitit 2014.
 3. **Blerja pajisje tableta dhe platforme e-learning** për shkollat e mesme të Përgjithshme 600 milion lekë, janë realizuar procedura e prokurimit dhe lidhur kontrata me vlerë 395 milion lekë, pagesa do të kryet me letër krediti vetëm pas realizimit 100% të kontratës.
 4. **Pajisje kompjuterike arsimi i mesëm i përgjithshëm** 22.9 milion lekë, janë realizuara me sukses procedura e prokurimit pro nuk është realizuar pagesa pasi kontrata vijon për vitin 2015.
 5. **Janë planifikuar 20 milion lekë** “Për Krijimin e fondit për bibliotekat shkollorë në arsimin e mesëm”, deri 31.10.2014, nuk janë realizuara procedurat e prokurimit dhe ky fond është rialokuar me VKM për të mbështetur me përparësi investimet në infrastrukturë.

Në total realizimi i shpenzimeve për periudhën 12- mujin 2014 në këtë program është 6 miliard e 148.5 milion lekë ose **94 %** të buxhetit të planifikuar.

Në total realizimi i fondeve për 12- mujorin 2014 në këtë program është realizuar në masën 94 % dhe përfaqëson rreth 13.7 % të fondeve të arsimit të realizuara të fondeve të MAS.

Sipas grup artikujve të dhënat janë sa vijon;

Shpenzimet korente	97 %
Shpenzimet kapitale	81 %
Gjithsej	94 %

Në këtë program janë parashikuar për t'u realizuar produktet e mëposhtem, ecuria e të cileve krahasuar me planin vjetor paraqitet ne tabelën ne vijim:

Kodi i Produkti	Emri i Produktit	Buxheti Vjetor 2014	Buxheti Vjetor Rishikuar 2014	Fakti 12-mujor 2014	Realizimi 12-mujor ne %
A	Shkolla ne arsimin e mesem te reabilituara/zgjeruara	314,233.0	509,364.0	486,117.4	95%
A	Shkolla te reja te ndertuara sipas standardeve europiane	158,636.0	158,636.0	148,999.0	94%
A	Laboratore IT te pajisura me kompjutera ne AMP.	26,869.0	26,869.0	0.0	0%
A	Biblioteka te pasuruara me literature bashkekohore	20,000.0	0.0	0.0	0%
A	Pajisje me TABLETA dhe platforme e-learning per kabinetet e informatikes	200,000.0	524,260	395,128	75%
	Shkolla/ klasa te pajisura me mobileri	52,000.0	52,000.0	52,000.0	100%
A	Krijimi i kushteve per realizimin e matures shteterore, hartimi i testeve per provimeve, procesi i dhenies se provimeve, vlerësimeve te provimeve deri ne shpalljen e rezultateve	99,398.0	118,928.2	115,624.2	97%
B	Realizimi i sherbimit arsimor, krijimin e shanseve të barabarta për të gjithë nxënësit për një arsimim cilësor, masiv dhe bashkëkohor, mirëmenaxhim të burimeve njerzore, fuqizimin dhe rritjen e autonomisë shkollore	5,036,552.0	5,055,494.3	4,891,383	97%
C	Trajnimi i 10-15% e punonjësve mësimore, për zbatimin kurikulës së gjimnazit, 50 mësuesve për mësimin e gjuhës e kultures shqipe ne diaspore. zhvillimi i praktikave profesionale nga 800 mësues të sapo diplomuar.	6,500.0	6,500.0	6,500	100%
D	Rishikimi i kurrikulave te Arsimit te Mesem te Pergjithshem.Realizimi i proceseve teknike dhe ligjore per hartimin e kurrikulave si dhe miratimi i ketyre standarteve dhe kurrikulave	4,000.0	4,000.0	3,800	95%
E	Sigurimi i teksteve shkollore per nxenesit e AMP dhe Mbeshtetja financiare per nxenesit nga shtresa sociale ne nevoje kompesim per blerjen e teksteve shkollore dhe rritjen e aksesit per ndjekjen e studimeve ne AMP (gjimnazet)	65,000.0	88,794.2	85,947	97%
F	Sigurimi i interneti per nxenesit e AMP	15,000.0	15,000.0	15,000.0	100%
		5,998,188.0	6,559,845.3	6,200,499.1	
	Shpenzime jashte buxhetore	10	10	0	
	TOTALI	5,998,188	6,559,855	6,148,509	

Nga tabela e mësipërme del që disa produkte nuk janë realizuar për 12-mujorit 2019;

1. Fondet “Për Krijimin e fondit për bibliotekat shkollore në arsimin bazë”, nuk janë realizuara procedurat e prokurimit, këto fonde u rialokuan me VKM.
2. Laboratore IT te pajisura me kompjutera ne AMP, janë zhvilluar me sukses procedurat e prokurimit lidhur kontrata por ende nuk është implementuar 100% e kontratës.

Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit për 12- mujorin 2014:

1. Vendimarrja me vonesë e komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, për fondet e zhvillimin e rajoneve 2014, nuk janë realizuar vetëm ato fonde që janë miratuar me thirrjen nr. I dhe thirrjen nr. II Gusht 2014. Të gjithë institucione përfituesve kanë kryer procedurat e prokurimit, për objektet e celura në 2014, si dhe lidhur kontratat
2. Në kuadër të likujdimit të detyrimeve për vitin 2012-2013 disa nga detyrimet e konstatuara nuk u realizuan fondet si pasojë e mangësive në dokumentacionin e paraqitur nga firma kontraktore, njësitë e qeverisjes vendore, si dhe moskonfirmimi nga DPT.
3. Kufizime buxhetore në muajt korrik 2014 nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Borxhit dhe Drejtoria e Thesarit pasi ende nuk janë konfirmuara për tu likujduar detyrimet e nga firma kontraktore, degët e tatimeve, degët e thesarit si dhe MAS, për të gjitha detyrimet/ kontratat e palikujduara vijon auditimi nga Ministria e Financave.

IV - ARSIMI I MESËM PROFESIONAL (Titulli i programit 09240).

Objektivat kryesorë për vitin 2014,

1. Rritja e regjistrimeve në klasën e X të me 8-10% ndaj vitit paraardhës. 25% e nxënësve që regjistrohen në arsimin e mesëm të ndjekin arsimin profesional.
2. Oferta e profesioneve të përputhet me kërkesat e tregut, vlerësuar me rritje 5 % e nxënësve të punësuar, (mbas 6 muajsh të përfundimit të shkollës) për çdo vit të PBA. Kjo bëhet e mundur edhe me përfundimin e pilotimit dhe masivizimit të modulit Moodle (pjesë e portalit të AP), ku nxënësit dhe mësuesit shkëmbejnë eksperiencë, materiale mësimore, etj.
3. **Rritja e numrit të nxënësve edhe nga zonat rurale** të vendit duke i mbështetur me politika favorizuese e sociale **përmes dhënies së 1850 bursave të reja për çdo vit të PBA**. Favorizimi i nxënësve në nevojë dhe sidomos për ato në degët në degët bujqësore, veterinarë, pyjorë, ndërtim, peshkim, gjeologji – miniera dhe shpim e shfrytëzim i vendburimeve të naftës dhe gazit.
4. Rritja e cilësisë së mësimdhënies nxënies dhe kushteve të shkollave e konvikteve , për **25 846 nxënës përfitues**, përmes pajisjes së 3 shkollave me Lab. digitalë të gjuhëve të huaja, 5 shkollave me Lab. virtual, instalimit të 5 Lab. Kimi-biologji, Fizike dhe Informatike; krijimit të 4 kab. të reja Elektroteknike, Mekanike; pajisjes së 4 shkollave artistike me mjete pune, etj; dhe tërheqjes dhe kualifikimit të mësuesve e specialisteve të kualifikuar.
5. **Akreditimi i 5 shkollave** dhe përputhja e kurrikulave me Kornizën europiane të kualifikimeve, përmes rishikimit të 50 skelet-kurrikulave profesionale për klasat 2, 3, 4 dhe i skelet-kurrikulave të reja prof. e social-kulturorë për klasat 2, 3, 4; Hartimi i 10 programeve për lëndët profesionale e social kulturorë.
6. **Mbështetje financiare për rreth 2 260 nxënësve**, që kryejnë praktika profesionale në biznes.
7. Mbështetje financiare për kompletimin e nxënësve me Tekste e Manualëve të praktikave me kurrikula në përputhje me nivelin e pestë të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Arritje 2014.

1. Modernizimi i arsimit profesional është prioriteti I Qeverisë Shqiptare. Reforma në këtë sistem synon të përshtatë programet dhe degët e shkollave profesionale në funksion të kërkesave të ekonomisë dhe tregut të punës.
2. Rritja e % numri i nxënësve të regjistruar në vitin e parë të arsimit të mesëm profesional në krahasim me një vit më parë, si rrjedhojë e hapjes së degëve dhe profileve të reja si ato të IT, agro-përpunimit, bujqësisë e ushqimit, turizmit dhe shërbimeve; përfundimi i ndërtimit të 4 shkollave të reja me kapacitet 700-800 nxenes secila si dhe pajisja e tyre me laboratorë, ngritjes së një sistemi modern të informimit të nxënësve të arsimit të detyruar dhe prindërve të tyre si dhe një sërë projekteve mbështetëse të qeverive të vendeve mike.
3. Transformimi i shkollave profesionale në qendra të hapura gjatë gjithë ditës, ku do të mësojnë jo vetëm nxënësit e rregullt, por edhe të rinj, të cilët, për shkaqe të ndryshme, kanë filluar të punojnë, si dhe të rriturit që dëshirojnë të formohen në një profesion. Reformimi i arsimit profesional do të jetë prioriteti kryesor i ministrisë në kuadër të programit IPA të BE-së.
4. **Rritja e ofertave të kurrikulave** dhe profileve në shkollat profesionale që reflektojnë kërkesat në tregun e punës, investimet në arsimin profesional kryesisht në rritjen e numrit të nxënësve që ndjekin drejtimin tekniko-profesional, rritjen e cilësisë dhe modernizimin e infrastrukturës fizike dhe laboratorike (punishtet për mësim praktik) në shkollat profesionale.
5. **Përfundimi për rindërtimin e 2 shkolla** profesionale me fondet e Bashkimit Europian (IPA), Vijnë procedurat për pajisjen e 8 shkolla profesionale me fondet e Bashkimit Europian (IPA) si dhe fonde të buxhetit të shtetit.
6. **Vijon mbështetja me bursa** rreth 3500- 4000 nxënësve që ndjekin shkollat profesionale në degët bujqësi, ndërtim dhe pyje, si dhe mbështetja me prioritet për të gjithë nxënësit konviktorë të vijnë nga 16 rrethe të zonave verilindore dhe juglindore të vendit dhe ndjekin shkollat profesionale.

7. **Tekste shkollore falas** për të gjithë nxënësit e komunitetit romë dhe rimbursim 100% për nxënësit e familjeve që marrin ndihmë sociale, për vitin 2013 përfituar kompesim financiar rreth 1500 nxënës dhe për vitin 2014 kanë përfituar tekste falas **1376 nxënës me vlerë 4.3 milion lekë**.
8. Mbështetjen financiare nga projekti i Qeverisë së Konfederatës të Zvicrës, faza e tretë e projektit “Mbështetje për Arsim dhe Formim Profesional Shqiptar me fokus profilin e Termohidraulikës dhe IT”.
9. **Janë hartuar 3 Skeletkurrikula të niv. II**, janë hartuar 2 Skeletkurrikula të niv. III, janë rishikuar 2 Skeletkurrikula që janë në zbatim, është hartuar Moduli pilot “Montimi dhe mirëmbajtja e sistemeve fotovoltaike”, është hartuar Materiali mësimor për Modulin pilot “Montimi dhe mirëmbajtja e sistemeve fotovoltaike”, janë përgatitur 3 paketa mësimore mbështetëse (120 fq. A4) për zbatimin e lëndëve dhe moduleve profesionale të AP.

Janë realizuar 19 përshkrime të profesioneve të përfunduara gjatë periudhës janar-shtator 2014,

- 216 Arkitektë, projektues, studiues dhe dizajner
- 312 Përgjegjës prodhimi (mbikëqyrës)
- 3121 Përgjegjës në minierë
- 3122 Përgjegjës prodhimi
- 3123 Përgjegjës ndërtimi
- 3321 Përfaqësues sigurimesh
- 3333 Kontaktues dhe agjentë punësimi
- 6310 Prodhues të produkteve bujqësore për nevoja familjare
- 6320 Prodhues të produkteve blegtorale për nevoja familjare
- 7124 Instalues dhe riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse
- 7125 Punëtorë të pastrimit të konstruksioneve të ndërtesave
- 7129 Punëtor ndërtimi të tjerë jo të klasifikuar diku tjetër
- 7536 Lëkurëpunues, regjës të lëkurës, përpunues të gëzofit dhe të ngjashëm
- 7542 Punëtorë të lëndëve plasëse dhe shpërthimeve
- 8111 Minatorë dhe punëtorë të gurores
- 8155 Punëtorë të makinave të përgatitjes së lëkurës dhe gëzofit
- 8156 Punëtorë të makinave të prodhimit të këpucëve dhe galanterisë
- 9311 Punëtorë në miniera e gurore
- 9313 Punëtorë të ndërtimit të banesave

Lista e përshkrimeve të kualifikimeve profesionale të përfunduara gjatë periudhës Janar-Shtator 2014 (4 kualifikime):

- Reception, niveli II në KKKP (niveli III në KSHK)
- Rrobaqepësi, niveli II në KKKP (niveli III në KSHK)
- Peshkim, niveli I në KKKP (niveli II në KSHK)
- Shërbime Detare në Kuvertë, niveli IV në KKKP (niveli V në KSHK)- me mbështetjen e Projektit EU-ILO-IPA 2010

Standartet e profesioneve dhe analiza e profesionit metodën DACUM të zhvilluara me mbështetjen e Projektit EU-ILO-IPA 2010 (2 standarde te profesionit):

III.1. Në kuadrin e pilotimit të mekanizmit të NJNM në fushën e tekstil-konfeksioneve dhe galanterisë, u hartuan me pjesëmarrjen e ekspertëve nga bizneset fasone:

1. Standardi i profesionit “Teknik Prodhimi”
2. Standardi i Profesionit “Kontrollor Cilësie”

III.2. Me mbështetjen e Projektit EU-ILO-IPA 2010, me pjesëmarrjen ekskluzive të përfaqësuesve të ekspertëve të detarisë, u hartua *Karta DACUM për “Shërbime Detare në Kuvertë”*.

Lista e skeletkurrikulave të reja për arsimin profesional (4 skeletkurrikula):

1. Profili “Agrobiznes” Niveli III”.
2. Profili “Shërbime karrocierie”, Niveli II
3. Profili “Elektromekanikë” Niveli II
4. Profili “Teknologjia e prodhimit të verës” Niveli II.

Programe të kurseve të shkurtra profesionale (2 programe):

1. “Minator dhe Armator” (300 orë).
2. “Zjarrmëtar” (210 orë)

Materiale mësimore mbështetëse për lëndët e arsimit profesional (11 materiale mësimore):

1. Për lëndën “Elektroteknikë dhe matje elektrike” kl.10, drejtimi “Elektroteknik”
2. Për lëndën “Histori e kostumeve dhe e modës”, kl.13, drejtimi “Tekstil -Konfeksione”.
3. Për lëndën “Sistemet moderne në mjetet e transportit”, kl.13 të drejtimit “Shërbime mjetesh transporti”.
4. Për lëndën “Kontabilitet”, kl.13 të drejtimit “Hoteleri turizëm”.

5. Për lëndën “Veglat dhe makinat e përpunimit të drurit”, kl. 10-11 të drejtimit “Përpunim druri”.
6. Për lëndën “Përmirësimi ujqor dhe sistemimi i tokave”, kl.13 të drejtimit “Bujqësi”.
7. Për lëndën “Rrjete kompjuterike”, kl.11 të drejtimit “TIK”.
8. Për lëndën “Ushqim”, kl. 12, të profileve “Bar restorant” dhe “Kuzhinë pastiçeri”.
9. Për lëndën “Makinat elektrike”, kl. 11 (temat 1-5), të drejtimit “Elektroteknik”
10. Për lëndën “Makinat elektrike”, kl. 11 (temat 6-10), drejtimi “Elektroteknik”
11. Për lëndën “Ekonomi ferme”, kl. 11, të drejtimit “Ekonomi bujqësore”.

Lista e programeve orientuese dhe instrumenteve të vlerësimit për provimet e niveleve në arsimin profesional (3 programe orientuese)

1. janë realizuar , 3 programe orientuese për dy drejtime mësimore (të dërguara në MAS)

1. “Ekonomi bujqësore” (niveli I)
2. “Teknologji agroushqimore” (niveli I)
3. “Prodhim bimor” (niveli II)

2. janë realizuar, banka me njësi testi për drejtimit: “Shërbim Mjetesh Transporti” dhe “TIK” (përgatitur për ëbsite-in e AKAFPK-së) (2 banka testesh)

Eshtë kryer monitorimi i zbatimit të skeletkurrikulave të AP dhe marrja e fidbekut në 15 shkolla profesionale të vendit.

Janë realizuar kontakte dhe udhëzime për drejtues, dhe mësues të shkollave profesionale për zbatimin e Skeletkurrikulave të AP. Janë dhënë kontribute për hartimin e 2 teksteve mësimore për lëndët e shkollave profesionale. Eshtë kryer trajnim didaktik i mësuesve që trajtojnë Modulin pilot “Montimi dhe mirëmbajtja e sistemeve fotovoltaike. Eshtë dhënë kontribut profesional në të gjitha angazhimit e kërkuara nga MASH dhe MMSR për aspekte të ndryshme të AFP.

Eshtë dhënë kontribut profesional në kuadrin e bashkëpunimit me sektorët e tjerë të AKAFPK (programe orientuese për provimet, përshkruesat kualifikimesh etj.) dhe me Institucione të tjera (IZHA, AKP, IKAP etj.). Eshtë dhënë kontribut profesional në grupet e ngritura nga projektet e ndryshme, si IPA-ILO, Projekti ALBIZ (K-education), AlbVET (Sëisscontact), “Mbështetja e AP në Shqipërinë Veri-Lindore” (GIZ) etj. U krye një monitorim i zbatimit të të nxënimit me projekte në profilin “Instalues termohidraulik”, mbështetur nga Programi AlbVET, si dhe u përgatit e prezantua raporti përkatës. Janë kryer veprimtari të drejtpërdrejta udhëzuese dhe trajnuese për PASO-t në kuadrin e bashkëpunimit me ALBIZ.

Janë dhënë kontribute për realizimin e konkursit të nxënësve në profilin “Kopshtari”, në kuadrin e bashkëpunimit me MEGATEK. Eshtë dhënë kontribut profesional (prezantime, diskutime, përgatitje materiale etj.) në kuadrin e pjesëmarrjes në veprimtari të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare (konferenca, takime, ëorkshope etj.). Janë kryer veprimtari vet-trajnuese (brenda sektorit), trajnuese dhe pjesëmarrje në vizita studimor.

Fondet e buxhetit për vitin 2014, për këtë program janë në masën **2 miliard e 214 milion lekë** dhe zë 5.6% të buxhetit të MAS, buxheti i rishikuar arrin në masën 2 miliard e 395 milion lekë ose rreth 5.15 të fondeve të arsimit, realizimi i shpenzimeve për 12- mujorin 2014 është në masën **2 miliard e 259.2 milion lekë** ose 94 % e planit vjetor, rreth 5.5% të shpenzimeve të realizuara të MAS

Shpenzime korrente të rishikuara për vitin 2014 janë **2 miliard e 90 milion lekë** dhe realizimi vjetor i shpenzimeve korrente për periudhën 12-mujore 2014, është në masën **1 miliard e 982.9 milion leke** ose **95%** e planit vjetor.

Fondet buxhetore për programin e arsimit profesional janë detajuar për 13 DAR, 10 ZA dhe 46 shkolla profesionale e socialkulturore, si dhe 30 njësi të qeverisjes vendore.

Shpenzime për personelin, ”pagat dhe sigurimet shoqërore (artikulli 600/601)” janë planifikuar 1 miliard e 800 milion lekë ose 73.4% e planit, buxheti i rishikuar për rreth 2, 302 punonjës (nga të cilët 1657punonjës mësimorë dhe 645 punonjës për shërbime mbështetëse, realizimi është ë masën **1 miliard e 745 milion lekë** ose **98%** e planit vjetor.

Fondet e planifikuara në grupin e shpenzimeve korente 602-606, për periudhën 12-mujore janë në masën 290.2 milion lekë, realizimi është në masën 82% ndaj planit vjetor, ku përfitues janë rreth **25 846** nxënës.

1. **Buxheti është detajuar** për shkollat profesionale e social kulturore nacionale, DAR/ZA dhe Aparati i MAS për blerje materiale dhe mjete didaktike 120.1 milion lekë, realizimi është në masën 79 milion lekë ose në masën 66%
2. Agjencia Kombetare e Arsimit dhe Formimit Profesional, Tirane **9.8 milion lekë realizimi është 9.5 milion lekë** ose në masën 97%;
3. Shpenzime për kuota ushqimore bursat e nxënësve për afro 3500-4200 nxënësve janë planifikuar 141.4 milion lekë realizimi për periudhën 12-mujore është 135.6 milion lekë ose rreth 96% ndaj planit vjetor 2014.
4. Për DAR Shkodër bursat për 84 nxënës të shkollës Austriake "Peter Mahringer" Shkodër rreth 8.2 milion lekë janë realizuar në masën 8.2 milion lekë ose 100% kundrejt planit 2014.
5. Shpenzime për në artikullin 606, - Kompesimi i blerjes së teksteve shkollore për rreth 1500 mijë nxënës janë planifikuar 6 milion lekë, realizimi është në masën 4.3 milion lekë ose 72% ku përfituan rreth 1 397 nxënës.

Shpenzimet për investime kapitale në programin Arsimi Profesional, janë 329 milion lekë, nga të cilat :

- a) 229 milion lekë financim i brendshëm ose 70%
- b) 100 milion lekë financim të huaj ose 30%

Realizimi i shpenzimeve kapitale për 12-mujorin e parë 2014 në këtë program është rreth 276 milion lekë ose 84% e planit të miratuar, sipas projekteve kryesore paraqiten:

- **Ndërtime të reja**, Financim i huaj për ndërtim dhe rikonstruksion objektsh shkollore të arsimit profesional nga projektet IPA 2008 -2010, fond i menaxhohet nga Delegacioni Europian, për shtimin e kapaciteteve në arsimin profesional 100 milion lekë, realizuar 91 milion lekë ose 91%
- Blerje pajisje për fuqizimi i bazave didaktike mesimore të zhvillimit të praktikës profesionale të shkollave të mesme në APT 41.7 milion lekë ose 23%
- Rikonstruksione për shkollat profesionale – 83.5 milion lekë, realizuar 22.7 milion ose 27%;
- Kabinete informatike (detyrim nga viti 2012-2013) - 22.6 milion leke, realizuar 27%;
- Pajisje mobilierie për konviktet – 10 milion lekë, **realizimi 9.8 milion leke ose 98%**.
- Pajisje mobilierie për shkollat – 10 milion lekë, **realizimi 9.8 milion leke ose 98%**.

Realizimi i fonde për programin e arsimit profesional për 12- mujorin 2014 është në masën **2 miliard e 395 milion lekë** ose 94 % e planit vjetor, rreth 5.5% të shpenzimeve të realizuara të MAS

Krahasuar me planin vjetor sipas grupit artikujve rezultojnë si më poshtë:

Shpenzimet korente	95 %
<u>Shpenzimet kapitale</u>	<u>91 %</u>
Gjithsej	94 %.

Në këtë program janë parashikuar për t'u realizuar produktet e mëposhtme, ecuria e të cileve krahasuar me planin vjetor jepet në tabelë:

Kodi i Produktit	Emri i Produktit	Buxheti Plan 2014	Buxheti i Rishikuar 2014	Fakti 12-mujor 2014	Realizimi 12-mujor ne %
A	Blerje pajisje për fuqizimi i bazave didaktike mesimore të zhvillimit të praktikës profesionale të shkollave të mesme në APT	40,000.0	42,900.0	42,899.81	100%
A	Ndërtime të reja për shtimin e kapaciteteve në arsimin profesional	233,436.0	177,571.0	175,489.63	99%
A	Blerje pajisje laboratorit për shkollat prof e soc-kultur, për rritjen e cilësisë mesimdhënies.	9,400.0	12,000.0	10,777.0	90%
B	Rikonstruksion e përmirësimi i infrastruktures së shkollave të mesme profesionale.	83,499.0	30,590.0	22,660.0	74%
C	Blerje pajisje mobilierie për pajisjen e klasave të ndërtuara dhe rindërtuara	16,927.0	16,927.0	14,697	87%

H	Blerje pajisje INFORMATIKE per pajisjen e klasave te ndertuara dhe rindertuara	15,000.0	15,000.0	0.0	0%
I	Blerje pajisje permiresimi i infrastruktures se Konvikteve per shkollat e mesme profesionale.	10,000.0	10,000.0	9,827.5	98%
A	Realizimi i sherbimit arsimor, krijimin e shanseve te barabarta per te gjithë nxënësit për një arsimim cilësor	1,861,781.0	1,883,877.1	1,790,098.3	95%
D	Trajnimi cdo vit 15-20% e punonjesve mesimore, per kurrikulat e reja ne AFP dhe zhvillimin profesional	3,400.0	3,400.0	3,400.0	100%
E	Vleresimi dhe Akreditimi i shkollave dhe përputhja e kurrikulave me Kornizën europiane te kualifikimeve.	28,185.0	27,314.3	25,339.5	93%
F	Sigurimi i teksteve shkollore per nxenesit e AProfesional dhe mbeshtetja financiare per nxenesit nga shtresa sociale ne nevojte kompesim per blerjen e teksteve shkollore dhe rritjen e aksesit per ndjekjen e studimeve ne AP	28,634.0	28,634.0	24,617.8	86%
G	Rritja e numrit të nxënësve ne AFP edhe nga zonat rurale te vendit duke i mbështetur me politika favorizuese e sociale	160,000.0	147,014	139,223	95%
		2,490,262.0	2,395,227.6	2,259,029.4	94%

Nga tabela e mësipërme del që disa produkte nuk janë realizuar për 12-mujorit 2014;

1. Blerje pajisje informatike, procedurat janë realizuar me sukses procedurat e prokurimit, por realizimi i kontratës nuk është implementuar brenda vitit 2014

Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit për 12- mujorin 2014:

1. Në FZHR 2014, nuk kishte kërkesa dhe projekte për objektet arsimore në arsimin profesional;
2. Disa projekte të miratuara nuk u zhvilluan procedurat e prokurimit dhe fonde u rialokuan ose nuk u realuan.
3. Në kuadër të likuidimit të detyrimeve për vitin 2012-2013 nuk u realizuan fondet si pasojë e mangësive në dokumentacionin e paraqitur nga firma kontraktore.
4. Kufizime buxhetore nga Drejtorja e Përgjithshme e Buxhetit, Borxhit dhe Thesarit pasi ende nuk janë likuiduar detyrimet e konfirmuara nga firma kontraktore, degët e tatimeve, degët e thesarit si dhe MAS prej muajit korrik 2014 vijon auditimi i detyrimeve të mbartura nga 2012-2013.

V - INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË. (Titulli i programit 09450)

Fondet buxhetore të planifikuara në programin e arsimit të lartë për vitin 2014 janë **5 miliard e 546.5 milion** lekë, buxheti i rishikuar për vitin 2014 është në masën **5 miliard 647.1 milion lekë me 13.3%** të fondeve të rishira për MAS. Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2014 në këtë program është në shumën **5 miliard e 629.3 milion lekë ose 100 %** e shpenzimeve të planifikuara. Shpenzimet e buxhetit të arsimit të lartë zënë **13.3%** të buxheti të MAS dhe **13.8 %** të shpenzimeve të realizuara të MAS.

Së bashku me të ardhurat në IAL publike realizimi arrin në vlerën e në **9.8 miliard lekë** ose **20.9%** të fondeve për MAS, realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2014 është **9.7 miliard lekë ose në masën 99%**. Shpenzimet e buxhetit të arsimit të lartë së bashku me të ardhurat dytësore zënë **21.5 %**, të shpenzimeve të realizuara të MAS

Objektivat kryesorë;

Objektiv 1. Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies për arritjen e standardeve të OECD, matur kjo me raportin student/pedagog, përmirësimin e metodave të mësimdhënies, rritjen e numrit të pedagogëve me 300, rritjen e numrit të laboratoreve shkencore dhe/ose përmirësimin dhe zgjerimin e tyre, duke rikonstruktuar e ngritur godina të reja për 15 000 studentë;

Objektiv 2. Sigurimi i cilësisë së programeve të studimit, dhe implementimi i sistemit të krediteve për studentët e IAL-ve bazuar në kualifikimin standart të sistemit të Bolonjës. Sigurimi i cilësisë në shërbimet që ofrojnë IAL përmes vlerësimit të brendshëm dhe vlerësimit të jashtëm të cilësisë.

Objektiv 3. Zgjerimin e sistemit të arsimit të lartë (AL) përmes: hapjes së rreth 30 kurrikulave të reja të MP/Msc dhe 10 programeve studimi me profile përkatëse të studimeve të Doktoratës, shtimit të studentëve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe inxhinierisë me 13%; shtimin me 5% të numrit studentëve në ciklin e dytë.

Objektiv 4. Rritja e autonomisë së IAL përmes, sigurimit të autonomisë akademike, strukturore, administrative dhe financiare. Diversifikim të burimeve të financimit, me qëllim optimizimin e investimit publik dhe privat në AL, në funksion të arritjes së objektivave të përgjithshme të AL. (vlerësuar me rritje të ardhurave në % ndaj PBB ose GDP për AL)

Objektiv 5. Përgatija e kuadrit ligjor dhe institucional për implementimin e reformës financiare në AL (formula e financimit, kredia studentore 2013-2015). Realizimi i politikave të përfshirjes sociale dhe aksesit të gjërë në AL nëpërmjet skemës së kredidhënies studentore dhe mbështetjes financiare për përmiresimin e kushteve në shtëpitë e studentëve.

Arritje në vitin akademik 2014

Për vitin akademik, 2013-2014, numri i pranimeve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë ka shënuar një rritje të pranimeve, ndaj studentëve që janë regjistruar dhe ndjekur studimet për vitin akademik 2013-2014.

- ✚ Gjatë vitit ka një risi në politikëbërje përmes një procesi të veçantë që u ndoq për Reformën e Arsimit të Lartë. Kemi tashmë gati një reformë tërësore të sistemit të arsimit të lartë, e cila synon rritjen e cilësisë në të gjithë sistemin, pa cenuar aspak mundësitë e të rinjve për t'u arsimuar, nëpërmjet ngritjes së një Komisioni të pavarur, i cili mundësoi një proces të zhvilluar në transparencë të plotë, duke garantuar gjithëpërfshirjen e grupeve të interesit, e aktorëve të AL-së pa asnjë përjashtim. Raporti përfundimtar i komisionit përfshiu të gjitha vërejtjet konstruktive, ndaj u mirëprit edhe nga ata që reformën e panë në fillim me dyshim.
- ✚ Janë ndërmarrë hapat e duhur në rrugën e kthimit të autoritetit të ligjit në institucionet e arsimit të lartë dhe në drejtim të frenimit të rrënimit të arsimit të lartë, si çelës i kthimit të besimit të publikut në IAL-të shqiptare, duke iniciuar procesin e Verifikimit të Kushteve të Ligjshmërisë në të gjitha IAL-të shqiptare, publike dhe private.
- ✚ Është realizuar vlerësimin paraprak dhe fillojmë punën për akreditimin e të gjitha IAL-ve me një agjenci britanike anëtare e ENQAS, brenda muajit dhjetor të këtij viti.
- ✚ Janë mbështetur mundësinë studentëve praktikantë dhe personelit akademik për të studiuar jashtë vendit, Sistemi i sigurimit të cilësisë në AL është fuqizuar dukshëm.
- ✚ Angazhimi i ekspertëve të huaj si vlerësues në terren dhe si antarë të Këshillit të Akreditimit ishte një hap shumë i rëndësishëm për fuqizimin e Agjencisë dhe Këshillit të Akreditimit dhe njohjen e tyre të plotë nga Strukturat internacionale të sigurimit të cilësisë. Gjithashtu janë fuqizuar njësitë e mbikqyrjes së cilësisë dhe inspektimit brenda MAS dhe në APAAL. IKAP, në vitin e dytë të veprimtarisë së tij, shënoi hapa të rëndësishme të konsolidimit të tij.
- ✚ Gjatë vitit 2014, në kuadër të marrëveshjeve bilaterale e shkëmbimit të studentëve e kërkuesve të rinj është realizuar regjistrimi i 6 studentëve kinezë pranë Fakultetit Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës dhe trajtimit të tyre me bursë, viti akademik 2013-2014;
- ✚ **Gjatë vitit 2014**, Ministria e Arsimit dhe Sportit në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, Fakultetin Histori-Filologji, në zbatim të marrëveshjeve dypalëshe me shtete të ndryshme. Organizimi i kursit të verës të gjuhës dhe kulturës shqipe, ku marin pjesë studentë dhe pedagogë të huaj rreth 30 studentë nga Fedarata Ruse.
- ✚ **Gjatë vitit 2014 nga sektori janë proceduar rreth 990** diploma universitare të lëshuar jashtë vendit, përfunduar procedura e njohjes dhe njësimit. Ndërsa rreth 200 të tjera janë në proces njohjeje.

Gjatë vitit 2014 në Këshillin e Akreditimit janë shqyrtuar;

1. **Për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin;** Vlerësimi i jashtëm institucional 7, vlerësimi i jashtëm i programeve të ciklit të parë 62, vlerësimi i jashtëm i programeve të ciklit të dytë 66, vlerësimi i jashtëm i programeve të ciklit të tretë 2.
2. **Për vlerësimin paraprak të programeve të reja të studimit:** vlerësimi paraprak i programeve të ri të studimit dyvjeçar 0, vlerësimi paraprak i programeve të studimit të ciklit të parë 53, vlerësimi paraprak i programeve të studimit të ciklit të dytë 111, vlerësimi paraprak i programeve të studimit të ciklit të tretë 7,
3. **Vlerësimin e dokumentacionit për hapjen e njësive:** Hapje fakulteti 4, riorganizim fakulteti 10, Ndryshim statusi i IAL 1,
4. **Vlerësimi i programeve të studimit pas plotësimit të kushteve:** Vlerësimi paraprak i programeve të ri të studimit dyvjeçar 1, Vlerësimi paraprak i programeve të studimit të ciklit të parë 1, Vlerësimi paraprak i programeve të studimit të ciklit të dytë 4.

5. Në Agjencinë Kombëtare të Provimeve po ndërtohet Baza Elektronike e të dhënave të arsimit të lartë, që përfshin *Regjistrin Kombëtar të Studentëve*, ku çdo student i regjistruar në cdo shkollë të lartë, publike apo private, që nga viti akademik 2011-2012, në të tri ciklet e studimeve universitare do të ketë numrin kombëtar të identifikimit, përveç atij që që ka marrë në universitetin ku studjon

Për vitin 2014 fondet e buxheti janë detajuar në 13 Universitete dhe shkolla të tjera të larta, dhe tre institucione të sistemit të arsimit të lartë, për afro 140 mijë studentë, që ndjekin studimet në tre cikle studimi në drejtime të ndryshme studimi.

Buxheti i shpenzimet korrente për vitin 2014, i planifikuar së bashku me të ardhurat e IAL në shumën 8 miliard e 654 milion lekë për periudhën 12- mujore është realizuar në masën 8 miliard 610 milion lekë 99.5%

✚ **Shpenzimet për zërin “pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve në artikullin 600/601”** janë planifikuar 4 miliard 425 milion lekë milion lekë për punonjesit e 13 Universitete dhe shkolla të tjera të larta, si dhe tre institucioneve Agjencia e Akreditimit Tiranë, Klubi Sportiv Studenti, Tiranë, si dhe Qendra e shërbimeve të rrjetit telematik Tiranë, realizimi i fondeve me burim nga buxheti i shtetit është realizuar 4 miliard e 421.3 milion lekë ose 100% së bashku me të ardhurat e realizuara nga IAL publike arrin në shumën 6 miliard e 280 milion lekë realizimi për periudhën 12-mujore është në masën 6 miliard 277 milion lekë 100 % .

✚ **Fondet për universitetet janë rialokuar në formën e grantit të pakushtëzuar.** Universitetet nëpërmjet organeve kolegjiale detajojnë këtë grant sipas njësive shpenzuese dhe zërave përkatës të buxhetit për shpenzime përsonele paga dhe sigurimet shoqërore të punonjësve **4 miliard 450** milion lekë ose rreth **100%** e transfertës së pakushtëzuar, realizimi i tyre është në masën 4 miliard e 450 milion lekëve ose 100% ndaj planit 2014.

✚ **Shpenzimet operative** artikulli **602-606**, ku përfshihen shpenzimet e funksionimit janë **945.2** milion lekë dhe realizimi është në masën 607.4 milion lekë ose 64%, **nga të cilat**

✚ **Shpenzimet për artikullin 603. Subvencionet** të Sh.a “Trajtimi i Studentëve” në Tiranë dhe në rrethe janë **350 milion** lekë për akomodimin 12000 studentë që akomodohen në mjediset shtëpive të studentëve, realizimi është në masën **350 milion lekë ose 100 %**.

✚ **Shpenzimet për zërin “Bursat e studentëve në artikullin 606”, janë planifikuar** 410 milion lekë për rreth 8 000 studentë që trajtohen me bursë nga IAL publike realizimi 9- mujor është në masën 405 milion lekë ose **99%**.

d) **Fondet për investime kapitale në programin** Arsimi e lartë , janë 390.5 milion lekë lekë, me financim të brendshëm, buxheti i rishikuar për vitin 2014 është 363.3 milion lekë. Realizimi i shpenzimeve kapitale për 12- mujorin 2014 në këtë program është 371 milion lekë ose 100 %, sipas projekteve kryesore paraqiten:

- **Përmirësim i infrastruktures ekzistuese te IAL dhe ngritja e godinave te reja** , Janë financuar 10 objekte/projekte, ndërtime të reja, si dhe shtesa objektesh shkollore në vazhdim nga viti 2012-2013 si dhe të miratuara në FZHR 2014 me vlerë financimi **291.8** milion lekë, realizimi 12- mujor është 291.8 milion lekë ose në masën 100%.
- **Ngritja dhe ristrukturimi i laboratoreve kerkimore -shkencore dhe/ose përmirësimin dhe zgjerimin e tyre.**, me vlerë 18.6 milion lekë realizimi 100%
- **Krijimi i Laboratoreve IT si dhe bibliotekave dixhitale** per rritjen e cilesise se mesimdhenies dhe kerkimit shkencor ne IAL , pajisje laboratorit etj me 26.4 milion lekë realizimi 100%.
- Përgatitja e regjistri elektronik kombëtar të diplomave universitare në bashkëpunim me RASH, parashikuar 25 milion lekë , realizimi 36.6 milion lekë. Në këtë projekt kemi tejklimit të fondeve të realizuara nga kapitulli 02 “Financimi Huaj”.

Në këtë program janë parashikuar për t’u realizuar produktet e mëposhtem, ecuria e të cileve krahasuar me planin vjetor jepet ne tabelë:

Kod Produkt	Emri i Produktit	Buxheti Plan 2014	Buxheti i Rishikuar 2014	Fakti 12- mujor 2014	Realizimi 12- mujor % ndaj planit vjetor 2014
A	Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies për arritjen e standardeve të OECD, matur kjo me raportin student/pedagog, përmirësimin e metodave të mësimdhënies, rritjen e numrit të pedagogëve	3,970,000.0	4,292,776.2	4,292,776.2	100.0%
B	Akreditimi institucional i IAL dhe kontraktimi i nje agjencie te huaj per	17,949.0	17,949.0		93.4%

	kete qellim. Reformam i mekanizmeve te kontrollit te cilesise			16,764	
C	Rritja e kapaciteteve ne staf dhe infrastrukture te IAL si dhe i nevojave te tregut te punes, rritjen e numrit te pedagogëve me 500-700, rritjen e numrit të laboratoreve shkencore dhe/ose përmirësimin dhe zgjerimin e tyre,	369,505.0	169,505.0	156,126.6	92.1%
D	Reformim i programeve doktorale duke parashikuar pune me kohe te plote ne departamentin perkates te doktorantit dhe integrimin e tij pergjate doktorates si pjese e njesise ku kryen doktoraten si dhe mundesimi nga ana ligjore i financimeve/bursave	30,000.0	35,000.0	33,329	95.2%
E	Përgatitja e regjistri elektronik kombëtar të diplomave universitare në bashkëpunim me RASH për të rritur transparencën dhe ulur korrupsionin si dhe i nje DB kombëtar për regjistrin e studentëve,	8,546.0	8,546.0	4,028	47.1%
F	Ndërtimi i kuadrit ligjor që mundëson lehtësira fiskale për subjektet fizike dhe juridike që financojnë me bursa për të gjitha ciklet e studimit studentët sidomos ato të kategorive në nevojë apo fonde për kërkim shkencor	410,000.0	410,000.0	405,077	0.0%
G	Realizimi i politikave të përfshirjes sociale dhe aksesit të gjërë në AL nëpërmjet skemës së kredithënies studentore dhe mbështetjes financiare për përmirësimin e kushteve në shtëpitë e studentëve,	350,000.0	350,000.0	349,664	99.9%
E	Krijimi i Laboratoreve IT si dhe bibliotekave dixhitale per rritjen e cilesise se mesimdhënies dhe kerkimit shkencor ne IAL , pajisje laboratorit etje	0.0	26,397.0	26,397	100.0%
F	Ngritja dhe ristrukturimi i laboratoreve kerkimore -shkencore dhe/ose përmirësimin dhe zgjerimin e tyre.	35,000.0	18,792.0	15,826	84.2%
G	Përmirësim i infrastruktures ekzistuese te IAL dhe ngritja e godinave te reja	125,500.0	292,738.0	292,736	100.0%
	Përgatitja e regjistri elektronik kombëtar të diplomave universitare në bashkëpunim me RASH	230,000.0	25,396	36,594	144.1%
		5,546,500	5,647,099	5,629,317	99.7%
	Jashte buxhetore	0	1,154,292	1,078,857	93.5%
	TOTALI	5,854,609	9,808,565	9,689,839	98.8%

Nga tabela e mësipërme evidentohet se disa produkte nuk janë realizuar;

1. Krijimi i laboratoreve të Informatikës IT, si rrjeti i telematik nderuniversitar.(procedurat janë në vijim, nuk është realizuar pagesa e parashikuar TVSH për vitin 2014, pasi pajisjet dhe softet e transferuara nga pala Italiane ende nuk kanë kaluar përfundimisht në proësi të palës shqiptare për Qendrën e Rrjetit Telematik te IAL)

Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit për 12- mujorin e vitit 2014:

1. Projekti për ngritjen dhe zhvillimin Qendrën e Rrjetit Telematik te IAL, investim i Qeverisë Italiane, administrimi dhe menaxhimi i fondeve me financim të huaj realizohet nga QNRRTSH në banka të nivelit të dytë,
2. **Mbajtja në “formë të ngrirë”** e një pjese e fondit prej 20 milion lekë të QNRRTSH, mosçelja e fodeve nga Ministria e Financave, ka penguar realizimin në tërësi të gjithë projektit, sipas afateve të përcaktuara në marrëveshje.

VI - Kërkimi Shkencor. (Titulli buxhetor i programit 09770)

Programi për Kërkimin Fundamental dhe Fondin e Ekselencës synon të mbeshtese kërkimin shkencor sipas prioriteteve kombëtare të zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe kulturor të vendit, si dhe tendencave të zhvillimeve globale në shërbim të IAL-ve e komunitetit shkencor. Në këtë kuadër kërkohet që puna kërkimore-shkencore të vihet në funksion të zgjidhjes së problemeve dhe ofrimit të alternativave për zhvillimin e vendit.

Fondet për këtë program janë planifikuar në total ne vleren **177 milion lekë, realizimi i shpenzimeve për 9- mujorin 2014** në këtë program është **19.8 milion lekë ose 10%** dhe përfaqëson rreth 0.4 % të fondeve buxhetit të MAS dhe 0.1% totalit të shpenzimeve të realizuara për 9- mujorin e vitit 2014

Objektivat kryesorë

- 1) Rritja dhe zgjerimi i kërkimit shkencor në Shqipëri bazuar në treguesit e OECD; ku pjesa e shpenzimeve publike në vitin 2014 të arrijë 0,50 % të GDP (e përllogaritur për IAL publike e private, ministritë e linjës, institucione të tjera kerkimore shtetërore, Akademia e Shkencave si dhe nga bizneset), Përgatitja e Strategjisë së re për Kërkimin Shkencor 2015-2020.

- 2) Nxijtja e punës kërkimore në IAL publike nëpërmjet financimit të drejtpërdrejtë të 3 200 kërkuesve, si dhe mbështetje financiare për kërkim fundamental në IAL publike me fonde nga buxheti i shtetit, mbështetje financiare për funksionim e mirëmbajtjen e laboratorëve didaktiko -kërkimorë në IAL publike. Aplikime dhe propozime projektsh për ngritjen e Qendrave të Ekselences (përfshi të ardhurat e IAL publike dhe Private).
- 3) Vlerësim të Kërkimit Shkencor në Shqipëri si dhe akreditimit të institucioneve dhe programeve të kërkimit (numri i programeve të vlerësuara do të rritet me 40 % në 2020 krahasuar me 2013).
- 4) Zgjerimi i bashkëpunimit të Universiteteve me biznesin privat në Programet Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit nëpërmjet organizimit të seminareve dhe takimeve informuese në IAL mbi Programet Kombëtare dhe Ndërkombëtare.
- 5) Pjesëmarrja në programin Horizon 2020, program për Kërkimin dhe Inovacionin (2014 - 2020). "Horizon 2020" do të bashkojë kërkimin me inovacionin dhe do të ketë një akses më të thjeshtë se programet paraardhëse për kompanitë dhe universitetet. "Horizon 2020" do të ketë tri shtylla kryesore: i) Shkencë - Ekselence, ii) Liderhip industrial, iii) Sfidat shoqërore. Finalizimi i marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe në fushën e kërkimit dhe teknologjisë.
- 6) Reformim i konceptit të Fondit të Ekselencës, me qëllim rritjen e efektivitetit të financimit dhe rikthimin e shpejtë të përfitimit të Shqipërisë, dhe të Brain Gain duke ndryshuar konceptin në Brain Circulation për të mundësuar kontributin e një kategorie më të gjerë profesionistesh për vendin. Mbështetja financiare për 50 studentet në 15 universitetet me të mira të botës (Lista Shanghai, ose FT) dhe doktorantë ekselentë, si dhe ekselentë apo të punësuar në kuadër të programit "Brain Gain"

Projekte që mbështeten me financim nga buxheti i shtetit si dhe nga marrëveshjet bilaterale e multilaterale për vitin 2014;

- ✚ Promovimi i Programeve Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit, nëpërmjet Konferencave dhe Seminareve të organizuara nga MAS si dhe IAL publike.
- ✚ Për vitin akademik 2014-2015, aplikuan pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, **7 aplikantë të ndërmjetëm (të cilët janë shpallur fitues në vitet akademike paraardhëse)**, për vazhdimin e mbështetjes financiare për kryerjen e studimeve. Në përfundim të fazave përzgjedhëse, **u kualifikuan si fitues 4 aplikantë dhe u nënshkruan akt-marrëveshjet.**
- ✚ **Për vitin 2013-2014 janë përfituar nëntë projekte TEMPUS** me vlerë 3.8 milionë Euro të cilët po zbatohen nga universitetet shqiptarë ose në partneritet me universitete të tjerë. Përsa i përket projekteve Tempus aktualisht janë duke u zhvilluar projektet TEMPUS 2012 dhe Tempus 2013
- ✚ **Programi me shumë përfitues për Tempus nën komponentin e IPA Asistenca për tranzicionin dhe ndërtimin institucional për vitin 2012**, nga ky program janë përzgjedhur tre projekte fituese si me poshte vijon:
 - 1) Projekti TEMPUS 2012 ,kodi projektit 530243 SMHES Developing Third Mission Activities in Albanian Universities me shume totale prej 727,825 Euro
 - 2) Projekti Tempus 2012 kodi projektit 530531 JPHEE E-learning, innovation and sustainable Albanian Agriculture me shume totale 503,568 Euro dhe me afat zbatimi 5.10.2012- 14.10.2015
 - 3) Projekti Tempus 2012 kodi projektit 530631 JPGR Empoëring Universities to fulfil their responsibilities for Quality Assurance me shume totale prej 858,625 Euro dhe me afat zbatimi 15.10.2012-14.10.2015.

Partnerët në këto projekte përfshijnë IAL, institucione biznesi si dhoma tregëtie të rretheve të ndryshëm, institucione publikë në fushën e Arsimit si MAS dhe AKTI dhe institucione të tjerë sikundër janë institucione publike në sektorë të caktuar si transporti etj. Krahasuar me 2011, kur në 5 projekte fituese kishim 13 IAL dhe partnerë të tjerë përfitues, këtë vit në 3 projekte fituese, kemi 21 IAL dhe partnerë të tjerë përfitues.

Programi me shumë përfitues për TEMPUS nën komponentin e IPA Asistenca për tranzicionin dhe ndërtimin institucional për vitin 2013.

Për vitin 2013, janë shpallur 9 projekte fituese, i cili është numri më i madh i projekteve fituese që Shqipëria ka pasur brenda një viti. Nga këto 9 projekte, përfitojnë gjithsej 44 partnerë shqiptarë nga të cilët 26 Institucione të Arsimit të Lartë (20 IAL Publike + 6 IAL Private) , 3 ministri dhe 15 institucione të tjera, biznese, agjenci, OJQ, etj

1. Tempus 2013 54327 JPHEs “Connecting Science-Society Collaborations for Sustainability Innovations” me kosto totale prej 968,206 Euro dhe me afat zbatimi 1.12.2013-30.09.2016
2. Tempus 2013 543782 JPCR “Developing and Adapting Professional Programs for Energy Efficiency in the Eastern Balkans” : 543,782 Euro dhe me afat zbatimi 1.12.2013-30.09.2016
3. Tempus 2013 544108 JPHEs Development of higher education and society by creating a collaborative environment in the field of arts and media through regional student partnerships in production of audio/video content me shume totale 827.621 Euro
4. Tempus 2013 544169, JPCR Competency Based Curriculum Reform in Nursing and Caring in Eastern Balkan Universities me shume totale prej 871,139 Euro
5. Tempus 2013 544257, JPCR Modernizing and harmonizing maritime education in Montenegro and Albania me shume totale prej 1,039,301 Euro dhe me afat zbatimi 1.12.2013-30.11.2016
6. Tempus 2013 544302 JPCR Enhancing Albanian system of quality assurance in higher education: Application of the process and outcomes in higher education: application of the process and outcome-based methodology me shume totale 627.832 Euro dhe afat zbatimi 1.12.2013-30.11.2016
7. Projekti Tempus 2013 JPCR 544362 Sport Professions – Education, Employment, Development in the Balkan Region me shume totale **1,006,985 Euro**
8. Projekti Tempus 2013 544504 JPCR Renewable energy studies in Eastern Balkans me shume totale **1,006,985 Euro** dhe me afat zbatimi 14.02.2014-01.10.2016
9. Projekti Tempus 2013 544595 JPHEs Lifelong learning for sustainable agriculture in Alps-Danube-Adriatic Region me shume totale **1,006,985 Euro** dhe me afat zbatimi 12.12.2013-12.12.2016

- ✚ **Programi bilateral me Italinë**, dhe të disa vendeve të tjera në kuadër të marrëveshjeve dypalëshe) kanë krijuar të gjitha mundësitë për një kualifikim të shpejtë dhe përfitim të përvojës internacionale aq të domosdoshme për përgatitjen e brezit të ri të profesoriatit të vendit tonë në nivele dhe standarde të krahasueshme me ato të vendeve të zhvilluara.
- ✚ Realizimi i vizitës së studiuesit grek Stratos Georgoulas nga Universiteti i Egjeut në Universitetin e Elbasanit, në kuadër të programit të bashkëpunimit kulturor ndërmjet RSH-Greqi.
- ✚ Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit të **Programit Lifelong Learning LLL** Te nxenit gjate gjithë jetes;
- ✚ **Marrëveshje Bashkëpunimi** ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ludëig-Maximilians-Universität München për mbështetjen e mësimdhënies dhe të hulumtimit shkencor në degën e studimeve të Albanologjisë;
- ✚ **Marrëveshja e bashkëpunimit** ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Universitetit Eötvös Loránd, Budapest, për ofrimin e mësimdhënies në disiplinën e gjuhës dhe kulturës shqipe, nënshkruar në Budapest më 20 mars 2012.
- ✚ **Nënshkrimi i marrëveshjes për aderimin e Shqipërisë në Erasmus +**, Programi i ri Kuadër i Bashkimit Evropian për arsimin trajnimin, rininë dhe sportin për periudhën 2014-2020. Ky program ofron 15 miliardë Euro financim në nivel evropian në fushat e studimit, punësimit, trajnimit dhe vullnetarizmit. Gjithashtu përmes këtij programi do të mundësohet aftësimi nëpërmjet eksperiencës gjuhës së huaj dhe shkëmbimeve në vendet e BE-së.
- ✚ Në kuadër të fushës së inovacionit dhe kërkimit shkencor, **Ministrja e Arsimit dhe Sportit ka firmosur marrëveshjen për aderimin e Shqipërisë në Horizon 2020**, Programi Kuadër i BE-së për kërkim dhe inovacion 2014-2020. Përmes një fondi prej 80 miliardë Euro, Horizon 2020 synon të ndihmojë për sigurimin e një rritjeje ekonomike të shpejtë, të qëndrueshme dhe me përfshirjen e të gjithë aktorëve (gjithëpërfshirëse). Pas një analize të detajuar kosto-përfitim duke u bazuar edhe tek eksperiencia e Shqipërisë në programet kuadër të mëparshëm në fushën e kërkimit shkencor (FP 7) dhe pas negociatave të vazhdueshme me Drejtorinë e Kërkimit dhe Inovacionit në BE është arritur reduktimi i tarifës që Shqipërisë i duhet të paguajë për pjesëmarrje në programin Horizon 2020 në masën 85%. Shqipëria merr pjesë në Horizon 2020 me të drejta dhe përfitime të plota sikundër edhe vendet anëtarë të BE-së dhe vendet e tjerë (përshebull fqinjët tanë në rrajon) pjesëmarrës në këtë program. Përmes aderimit në Horizon 2020 Shqipëria gjithashtu plotëson me sukses një prej rekomandimeve më thelbësorë të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për kapitullin 25 “Shkenca dhe Kërkimi Shkencor” i cili është integrimi i Shqipërisë në Zonën Evropiane të Kërkimit Shkencor (European Research Area). Gjithashtu pjesëmarrja në Horizon 2020 ndihmon për të siguruar një bashkërendim ndërmjet zhvillimit shkencor, programeve të zhvillimit

kombëtar dhe atyre ndërkombëtar. Më konkretisht pjesëmarrja në Horizon 2020 forcon edhe bashkërendimin dhe partneritetin ndërmjet aktorëve të sektorëve të bujqësisë, shëndetësisë, sigurisë, energjisë, , transportit dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME).

Gjithashtu në kuadër të kërkimit shkencor dhe në përputhje me prioritetet e qeverisë shqiptare për hapjen e qendrave të ekselencës po punohet për realizimin e dy projekteve.

- ✚ **Projekti për realizimin e Qendrës Ndërkombëtare të Kërkimit Detar (CISM) në Vlorë.** Ky projekt, i mbetur në fazën e studimit paraprak që në vitin 2008 është një bashkëpunim ndërmjet kërkuesve shqiptarë dhe CONISMA (konsorcium i mbi 36 universitetesh dhe shkencëtarësh në fushën e kërkimeve detare në Itali). Pas ri-aktivizimit të këtij projekti, aktualisht është krijuar grupi I punës dhe palët do të takohen në shtator për përcaktimin e fazave të mëtejshme për konkretizimin e tij.
- ✚ Projekti i dytë i rëndësishëm në fushën e kërkimit shkencor është **projekti Albano. Ky projekt synon ngritjen në Shqipëri të një qendre ekselence në fushën e nano-teknologjisë.** Projekti është një partneritet ndërmjet ICN (konsorcium universitetesh dhe kërkuesish shkencorë spanjoll) dhe universitetit Politeknik të Tiranës, Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe fakultetit të mjekësisë. Ministria e Arsimit dhe Sportit luan rolin e koordinatorit të këtij projekti. Aktualisht po punohet për përgatitjen e projekt-propozimit dhe synohet aplikimi I tij në një thirrje në kuadër të programit Horizon 2020 në shtator 2014.
- ✚ **Projekt tjetër i rëndësishëm në fushën e arsimit është gjithashtu edhe projekti për racionalizimin e rrjetit të shkollave (ËBIF).**
- ✚ **Është miratuar projekti për Dixhitalizimin Kombëtar të Sistemit Arsimor Parauniversitar me ndihmën e qeverisë së Republikës së Austrisë.**
- ✚ Një tjetër projekt në fushën e arsimit është projekti shkollat shqiptare të gjelbërta për një të ardhme të qëndrueshme nëpërmjet efikasitetit energjitike. Për këtë projekt është ndërmarrë një studim në bashkëpunim me Arizona State University, ShBA **Linku ku mund të gjendet prezantimi: <http://prezi.com/zusozxi-hfte/ne-300-dite-kerkim-inovacion/>**

✚ **Sfida kryesore në fushën e kërkimit shkencor mbetet rritja e investimit privat në shkencë.**

Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2014 në këtë program është **172.8 milion lekë ose 97%** e planit vjetor dhe përfaqëson rreth 0.6 % të fondeve buxhetit të MAS ose 0.6% totalit të shpenzimeve të realizuara për 9- mujorin e vitit 2014, **së bashku me fondet e realizuara nga të ardhurat e donatorëve si dhe të IAL publike shpenzimet për periudhën 12-mujore janë realizuar në masën 190.7 milion lekë 97% e ndaj planit të rishikuar për vitin 2014**

Sipas zërave kryesore, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

Shpenzime korente	97 %
Shpenzime kapitale	100 %
Totali	97 %

Në këtë program janë parashikuar per t'u realizuar produktet e mëposhtem, ecuria e të cileve krahasuar me planin vjetor jepet ne tabelë:

Kodi i Produktit	Emri i Produktit	Buxheti Plan 2014	Buxheti i Rishikuar 2014	Fakti 12-mujor 2014	Realiz 12-mujor në % 2014
A	Pjesmarrja e Programe Nderkombetare te Bashkepunimit Shkencor e Teknologjik te mbeshtetura financiarisht.	8,000.0	8,500.0	8,458.4	100%
B	Pjesmarrje me projekte te mbeshtetura financiarisht ne kuader Erasmus +, HORIZON 2020	15,000.0	90,000.0	90,000.0	100%
C	Programe Kerkimore Universitare dhe i Shkollave te larta dhe kerkues te rinj te mbeshtetura financiarisht.	0.0	0.0	0.00	0%
D	Mbeshtetje per Projekte te Rendesise se vecante te mbeshtetura financiarisht nga MASH.	4,000.0	4,824.2	3,033.2	0%
E	Promovimi i projekteve ne kuadrin e Programeve Kombetare dhe Nderkombetare te Kerkimit dhe Zhvillimit, nepermjet Konferencave dhe Seminareve te organizuara nga MASH	0.0	0.0	0.0	0%
F	Kerkues dhe shkencetare TE rinj qe kryejne studimet e tyre Universitare & sudime doktorature ne 15 universitet me te mira te botes, si programi BRAIN GAIN	150,000.0	75,000.0	71,279.6	95%
	TOTALI	177,000	178,324	172,771	97%
	Shpenzime jashte buxhetore	12,563	17,892	17,892	100%

		189,563	196,216	190,663	97%
--	--	---------	---------	---------	-----

VII – Programi për Zhvillimin e Sportit . (Titulli buxhetor i programit 08140)

Synimet këtij programit **për Zhvillimin e Sportit** janë; Sigurimi dhe mbrojtja e të drejtave të shtetasve, që merren me edukim fizik dhe sport, në përputhje me Kartën Evropiane të Sportit dhe me rekomandimet e organizatave ndërkombëtare në këtë fushë. zbatimin dhe përmirësimin e politikave shtetërore për sportin Elitar dhe sportin në institucionet arsimore në drejtimin organizativ, teknik dhe funksional, qendror dhe lokal. Krijimin e shanceve të barabarta dhe kushteve për pjesëmarrjen në aktivitete sportive të të gjithë shtetasve shqiptar mbështetur në të drejtat e njeriut për të ushtruar aktivitet fizik e sportiv, duke krijuar infrastrukturën e duhur ligjore, financiare dhe fizike, rregullimin e mardhenieve shtet-institucione sportive. Siguron shërbim cilësor në sistemin Arsimor parauniversitar dhe atë universitar, duke qënë se sporti është pjesë përbërëse e programit të edukimit të nxënësve dhe studentëve në institucionet arsimore publike dhe jopublike.

Fondet për këtë program janë planifikuar në total ne vleren **168 milion lekë buxheti i rishikuar është 818.4 milion lekë, realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2014** në këtë program është **808.2 milion lekë ose 99%** dhe përfaqëson rreth 1.9 % të fondeve buxhetit të MAS dhe 2% totalit të shpenzimeve të realizuara për 12-mujorin e vitit 2014

Objektivat e planifikuara për vitin 2014

- 1) Rishikimi i formës së financimit në sistemin sportiv kombëtar në përputhje me Ligjin e Sportit, me synim respektimin e pavarësisë së tyre funksionale si organizata jofitimprurëse , në kuadër të miremenaxhimit të fondeve publike që do të kenë në dispozicion këto oragnizatrat sportive duke respektuar mireadministrimin, disiplinimin dhe përdorimin me efikasitet të fondeve .
- 2) Rritja e mbështetjes financiare për aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombetare për Federatat Sportive për të gjitha disiplinat sportive, sipas kalendareve të aktiviteteve në 38 Kampionate Kombetare dhe 38 Kupa Shqiperisë, 38 Kampionate Evropiane , si dhe 38 Kampionate Boterore
- 3) Rishikimi i Statusit dhe rritja e mbështetjes financiare të sportistëve elitare, duke përcaktuar standardet e arritjeve/ titujve/rekordeve dhe medaljeve si dhe masën e shpërblimit të sportistëve që do të arrijnë rezultate në aktivitetet ndërkombëtare
- 4) Reformimi i keshillave konsultative te Sportit, Mbështetja e Agjensise se Sherbimit te Sportit ne përmirësimin e infrastruktures së objekteve qe ajo ka ne administrim. 5). Krijimi i kushteve per rishikimin e formes dhe funksionimit te Klubeve Sportive
- 6) Mbështetje financiare e aktiviteteve të ekipeveve sportive perfaqesues të shkollave ne disiplina te ndryshme , me synim hedhjen e bazes per krijimin e shoqatave Sportive shkollore;

Standardet e politikës së programit

- + a) 15-20% ne vit trajnime për stafet teknike të sistemit sportiv kombëtar (532 tenike-trainere,speciliste, instruktorë, mjekë etj).
- + b) mbështetje financiare të sportistëve për 15-20 sportistë elitare në vit, c) përmirësimin e infrastruktures së objekteve sportive të futbollit, basketboll, volejball, peshëngritje, mundje, arte marciale etj; d) rritje e numrit te sportivëve të licensuar në federata shqiptare të sportit,
- + e) numri i pjemarrjeve në aktivitetet kombëtare: e) numri i pjemarrjeve në aktivitetet ndërkombëtare:
- + f) numri i medaljeve në aktivitetet ndërkombëtare:

Arritje për periudhën 12-mujore Janar- Shattor 2014

- + Është realizuar ndryshimi në skemën e financimit të sportit referuar nenit 10/1 ligjit Nr.9376 datë 21.04.2005 i ndryshuar, me Udhëzimi e Përbashkët nr.4 date 11.-3.2014 të Ministrit të

Arsimit dhe Sportit dhe Ministrin të Financave “Për mënyrën e përdorimit të fondit grand/transferte korrente të brendshme për federatat dhe Komitetin Olimpik shqiptar”

- ✚ Është realizuar shpërblimi për 3 sportistë Elitar gjatë vitit 2014 për medaljet e fituara në aktivitetet ndërkombëtare .
- ✚ Është realizuar VKM e veçantë për mbështetjen e Federatës Shqiptare të Peshëngritjes për grumbullimin dhe pjesëmarrjen e Ekipit Kombëtar Meshkuj +Femra në kampionatin botëror.
- ✚ Është realizuar mbështetja financiare për 20 federatave sportive me fond për zhvillimin e aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare.
- ✚ Është realizuar me VKM, riorganizimi i Agjencisë së Shërbimit të Sportit si në aspektin teknik ashtu dhe atë administrative, përgatitja e ngritjes së një qendër kombëtare ku është krijuar dokumentacioni i posaçëm për investimin në këtë qendër.
- ✚ Është realizuar financimi për ristrukturimin e “Parkut Olimpik të Tiranës me vlerë **600 milion lekë**
- ✚ Gjithashtu është realizuar bashkëfinancimi me VKM i ristrukturimit të Stadiumi Elbasan Arena, së bashku me federatën shqiptare të futbollit si dhe Bashkinë Elbasan një investim i rëndësishëm është dhe i cili është tashme brenda standardeve të përcaktuara nga UEFA-FIFA për zhvillimin e aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare me vlerë **444 milion lekë**.

Programi	Programi Per Zhvillimin e Sportit				
Kodi i		Buxheti	Buxheti Vjetor	Fakti 12-mujor	Realiz ne % I buxhetit per vitin 2014
Produktit	Emri i Produktit	Plan 2014	Rishikuar 2014	2014	
A	Rishikimi i formës së financimit në sistemin sportiv kombëtar në përputhje me Ligjin e Sportit,	10,000.0	0.0	0.0	0%
B	Rritja e mbështetjes financiare për aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare	75,000.0	553,201.6	555,350.0	100%
C	Statusit dhe rritja e mbështetjes financiare të sportistëve elitare, duke përcaktuar standardet e arritjeve/ titujve/rekordeve dhe medaljeve si dhe masën e shpërblimit të sportistëve që do të arrijnë rezultate në aktivitetet ndërkombëtare	10,000.0	15,000.0	15,000.00	100%
D	Krijimi i kushteve për rishikimin e formës dhe funksionimit të Klubeve Sportive	49,600.0	42,603.9	36,197.0	85%
E	Mbështetje financiare e aktiviteteve të ekipeve sportive përfaqësues të shkollave në disiplinën e ndryshme, me synim hedhjen e bazës për krijimin e shoqatave Sportive shkollore	2,400.0	2,400.0	2,400.0	100%
F	Mbështetja financiare e programeve për kërkimin shkencor dhe kualifikimin shkencor në sport, Mbështetja e programeve trainuese në sistemin sportiv kombëtar në funksion të rritjes së kapaciteteve në fushën e sportit	1,000.0	1,000.0	1,000.0	100%
G	Mbështetja financiare me investime për ristrukturimin/ ndërtimin dhe pajisjen e objekteve sportive pranë Agjencisë së Shërbimit të Sportit në funksion të përmirësimit të kushteve, për nxitjen e numrit të ushtuesve në sport	20,000.0	205,141.1	201,964.8	98%
	TOTALI	168,000.0	819,346.6	808,220.8	
	Shpenzime jashtë buxhetore	0	519	519	100%
		168,000	819,866	808,740	99%